



# FLETORJA ZYRTARE

## E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

**Nr.43**

**2005**

**13 qershor**

### P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9382 datë 4.5.2005	Për ratifikimin e “Konventës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Holandës, për shmangien e tatimeve të dyfishta dhe për parandalimin e evazionit fiskal për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin” .....	1533
Ligj nr.9383 datë 4.5.2005	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin” .....	1553
Ligj nr.9384 datë 4.5.2005	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Korporatës Amerikane “Lockheed Martin Global INC (LMGI)”, për ndërtimin e sistemit të integruar të vëzhgimit të hapësirës detare”, nënshkruar në Tiranë më 15 mars 2005 .....	1566

**LIGJ**  
**Nr. 9382, datë 4.5.2005**

**PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
MBRETËRISË SË HOLANDËS, PËR SHMANGIEN E TATIMEVE TË DYFISHTA DHE  
PËR PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL PËR TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE  
MBI KAPITALIN”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet “Konventa ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Holandës, për shmangien e tatimeve të dyfishta dhe për parandalimin e evazionit fiskal për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4588, datë 1.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

**KONVENTË**  
**NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË HOLANDËS PËR  
SHMANGIEN E TATIMEVE TË DYFISHTA DHE PËR PARANDALIMIN E EVAZIONIT  
FISKAL, LIDHUR ME TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN**

Republika e Shqipërisë dhe Mbretëria e Holandës,  
*duke dëshiruar*, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm dhe lehtësimin e marrëdhënieve ekonomike, të përfundojnë një Konventë për shmangien e tatimeve të dyfishta dhe për parandalimin e evazionit fiskal, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin,  
kanë rënë dakord për sa vijon:

**KAPITULLI I**  
**FUSHËVEPRIMI I KONVENTËS**

**Neni 1**

**Personat që mbulohen**

Kjo Konventë do të aplikohet ndaj personave që janë rezidentë të njërit apo të dy Shteteve Kontraktuese.

Neni 2  
**Tatimet që mbulohen**

1. Kjo Konventë do të zbatohet ndaj tatimeve mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të zbatuara në emër të një Shteti Kontraktues apo të nënndarjeve të tij politike apo autoriteteve lokale, pavarësisht nga mënyra në të cilën ato vilen.

2. Do të konsiderohen tatime mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të gjitha tatimet e vendosura mbi të ardhurat totale, mbi kapitalin total apo mbi elemente të të ardhurave apo të kapitalit, përfshirë tatimet mbi fitimet nga tjetërsimi i pasurive të tundshme apo të patundshme, tatimet mbi shumat totale të rrogave dhe pagave të paguara nga sipërmarrjet, si edhe tatimet mbi vlerësimin e kapitalit.

3. Tatimet ekzistuese ndaj të cilave do të zbatohet Konventa janë në veçanti:

a) në Shqipëri:

i) tatimet mbi të ardhurat (përfshirë tatimin mbi fitimet e kompanive dhe tatimin mbi të ardhurat personale);

ii) tatimin mbi biznesin e vogël;

iii) tatimin mbi pasurinë;

(në vijim do t'u referohemi si "Tatimet shqiptare").

b) në Holandë:

- de inkomstenbelasting (tatimi mbi të ardhurat);

- de loonbelasting (tatimi mbi pagat);

- de vennootschapsbelasting (tatimi mbi kompanitë) përfshirë pjesën e qeverisë në fitimet neto nga shfrytëzimi i burimeve natyrore të vjelura në bazë të Mijnwet 1810 (Ligji për minierat i vitit 1810), lidhur me koncesionet e dhëna që nga 1967, ose në bazë të Mijnwet Continentaal Plat 1965 (Ligji holandez për gërmime të Shelfit Kontinental të vitit 1965);

- de dividendbelasting (tatimi mbi dividendët);

(në vijim do t'u referohemi si "Tatimet holandeze").

4. Konventa do të zbatohet gjithashtu ndaj çdo tatimi të njëjtë apo esencialisht të ngjashëm të vendosur pas datës së nënshkrimit të Konventës si shtojcë apo në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të njoftojnë njëri-tjetrin për çdo ndryshim sinjifikativ që bëhet në ligjet e tyre tatimore përkatëse.

**KAPITULLI II  
PËRKUFIZIME**

Neni 3  
**Përkufizime të përgjithshme**

1. Për qëllime të kësaj Konvente, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe:

a) termat "një Shtet Kontraktues" dhe "Shteti tjetër Kontraktues" nënkuptojnë Mbretërinë e Holandës (Holandën) ose Shqipërinë si ta kërkojë përmbajtja; termi "Shtete Kontraktuese" nënkupton Mbretërinë e Holandës (Holandën) dhe Shqipërinë;

b) termi "Holanda" nënkupton atë pjesë të Mbretërisë së Holandës që ndodhet në Europë, përfshirë ujërat e saj territoriale, dhe çdo zonë përtej ujërave territoriale brenda të cilave Holanda, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, ushtron juridiksion ose të drejta sovraane lidhur me tabanin detar, nëntokën e tij, ujërat sipërfaqësore dhe burimet e tyre natyrore;

2. Përsa i takon aplikimit të Konventës në çdo kohë nga një Shtet Kontraktues, çdo term i papërcaktuar këtu, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe, do të ketë kuptimin që i është dhënë në atë kohë në legjislacionin e atij shteti për qëllime të tatimeve ndaj të cilave zbatohet Konventa; çdo kuptim i dhënë në ligjet tatimore në fuqi të atij shteti do të ketë përparësi ndaj kuptimit që i jepet termit në ligje të tjera të atij shteti.

#### Neni 4 **Rezidenti**

1. Për qëllime të kësaj Konvente, termi “rezident i një Shteti Kontraktues” nënkupton çdo person që, sipas ligjeve të atij shteti, i nënshtrohet tatimeve atje për shkak të qëndrimit, banimit, vendit të menaxhimit, vendit të regjistrimit apo çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme dhe gjithashtu përfshin atë shtet dhe çdo nënndarje politike apo autoritet lokal atje. Megjithatë, ky term nuk përfshin personat që i nënshtrohen tatimit në atë shtet lidhur vetëm me të ardhurat nga burime në atë shtet apo nga kapitali i vendosur aty.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1 një individ është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëherë statusi i tij do të përcaktohet si vijon:

a) ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit në të cilin ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij; nëse ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në të dy shtetet, ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit me të cilin interesat e tij personale dhe ekonomike janë të lidhura më ngushtë (qendra e interesave jetike);

b) nëse shteti në të cilin ai ka qendrën e interesave të tij jetike nuk mund të përcaktohet ose nëse ai nuk ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në asnjërin shtet, ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit në të cilin qëndron zakonisht;

c) nëse ai qëndron zakonisht në të dy shtetet apo në asnjërin prej tyre, ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit nënshtetas i të cilit ai është;

d) nëse nga kriteri i mëparshëm nuk është e mundur të përcaktohet Shteti Kontraktues rezident vetëm i të cilit të konsiderohet ai person, atëherë autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të përpiqen që ta zgjidhin çështjen me mirëkuptim reciprok.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1 një person joindivid është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëherë ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv.

#### Neni 5 **Selia e përhershme**

1. Për qëllime të kësaj Konvente, termi “seli e përhershme” nënkupton një vend fiks biznesi nëpërmjet të cilit ushtrohet tërësisht ose pjesërisht biznesi i sipërmarrjes.

2. Termi “seli e përhershme” përfshin në veçanti:

a) një vend menaxhimi;

b) një degë;

c) një zyrë;

d) një fabrikë;

e) një punishte;

f) një minierë, një pus naftë ose gazi apo çdo vend tjetër për shfrytëzimin e burimeve natyrore.

3. Termi “seli e përhershme” gjithashtu përfshin:

a) një shesh ndërtimi, konstrukcion apo projekt instalimi kur zgjat më shumë se nëntë muaj;

b) furnizimin e shërbimeve, përfshirë shërbimet e konsulencës, nga një sipërmarrje nëpërmjet të punësuarve apo personelit të vënë nga ndërmarrja për këtë qëllim, por vetëm nëse aktivitetet të kësaj natyre vazhdojnë brenda vendit për një periudhë apo periudha që në total i kalojnë nëntë muaj në çdo periudhë dymbëdhjetëmuajore që fillon ose përfundon në vitin përkatës fiskal.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mëparshme të këtij neni, termi “seli e përhershme” nuk do të përfshijë:

a) përdorimin e ambienteve vetëm për qëllime magazinimi apo ekspozimi të mallrave që i përkasin sipërmarrjes;

b) mbajtjen e një gjendje mallrash që i përkasin sipërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi apo ekspozimi;

c) mbajtjen e një gjendje mallrash që i përkasin sipërmarrjes vetëm për qëllim përpunimi nga një sipërmarrje tjetër;

d) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim të blerjes së mallrave apo për mbledhje informacioni për sipërmarrjen;

e) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim të ushtrimit për sipërmarrjen të çdo aktiviteti me karakter përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person — i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur ndaj të cilit aplikohet paragrafi 6 — vepron në emër të sipërmarrjes dhe ka, dhe zakonisht e ushtron, në njërin Shtet Kontraktues, autoritetin për të përfunduar kontrata në emër të sipërmarrjes, ajo sipërmarrje do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në atë shtet lidhur me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për sipërmarrjen, përveç kur aktivitetet e këtij personi kufizohen në ato të përmendura në paragrafin 4, të cilat edhe kur ushtrohen nëpërmjet një vendi fiks biznesi, nuk do ta bënin këtë vend fiks biznesi të konsiderohej një seli e përhershme nën dispozitat e atij paragrafi.

6. Një sipërmarrje nuk do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në një Shtet Kontraktues vetëm për faktin se ushtron biznes në atë shtet nëpërmjet një ndërmjetësi, agjenti komisioner të përgjithshëm apo çdo agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që këta persona të veprojnë në kuadrin e zakonshëm të biznesit të tyre. Megjithatë, kur aktivitetet e një agjenti të tillë ushtrohen tërësisht apo thuhet tërësisht në emër të asaj sipërmarrje, dhe kushtet e rena dakord apo të vëna midis asaj sipërmarrje dhe agjentit në marrëdhëniet e tyre tregtare dhe financiare, ndryshojnë nga ato që do të ishin vendosur midis sipërmarrjeve të pavarura, ai agjent nuk do të konsiderohet një agjent me status të pavarur në kuptimin e këtij paragrafi.

7. Fakti që një kompani që është rezidente e një Shteti Kontraktues kontrollon apo kontrollohet nga një kompani që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues, apo që ushtron biznes në atë shtet tjetër (qoftë nëpërmjet një selie të përhershme apo ndryshe), nuk përbën arsye të mjaftueshme për ta konsideruar një kompani seli të përhershme të tjetrës.

### KAPITULLI III TATIMI I TË ARDHURAVE

#### Neni 6

#### **Të ardhurat nga pasuria e patundshme**

1. Të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga pasuritë e patundshme (përfshirë të ardhurat nga bujqësia apo pyjet) të ndodhura në Shtetin tjetër Kontraktues mund të taten në këtë shtet tjetër.

2. Termi “pasuri e patundshme” do të ketë kuptimin që është dhënë në legjislacionin e Shtetit Kontraktues në të cilin është vendosur pasuria në fjalë. Në çdo rast termi do të përfshijë pasuritë aksesore të pasurisë së patundshme, gjënë e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi dhe në pyje, të drejtat ndaj të cilave aplikohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm lidhur me pronësinë mbi tokën, uzufukti i pasurive të patundshme dhe të drejtat ndaj pagesave fikse apo të ndryshueshme që jepen si shpërblim për shfrytëzimin, apo të drejtën e shfrytëzimit të zonave dhe burimeve minerare dhe burimeve të tjera natyrore. Anijet dhe avionët nuk do të konsiderohen pasuri e patundshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen ndaj të ardhurave nga përdorimi direkt, nga qiradhënia apo përdorimi në çdo formë tjetër i pasurive të paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 do të zbatohen gjithashtu ndaj të ardhurave nga pasuria e patundshme e një sipërmarrjeje dhe ndaj të ardhurave nga pasuria e patundshme e përdorur për kryerjen e shërbime personale të pavarura.

## Neni 7 Fitimet biznesore

1. Fitimet e një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues do të taten vetëm në atë shtet, përveç kur sipërmarrja ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty. Nëse sipërmarrja ushtron biznes si më sipër, fitimet e sipërmarrjes mund të taten në shtetin tjetër, por vetëm ajo pjesë e tyre që i atribuohet asaj selie të përhershme.

2. Pa cenuar dispozitat e paragrafit 3, kur një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, atëherë në secilin Shtet Kontraktues asaj selie të përhershme do t'i atribuohen fitimet që ajo do të mund të realizonte nëse do të ishte një sipërmarrje e veçantë dhe e ndarë, e përfshirë në të njëjtin aktivitet apo në aktivitete të ngjashme, në kushte të njëjta ose të ngjashme dhe tërësisht e pavarur nga sipërmarrja, një seli e përhershme e së cilës ajo është.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme, do të lejohet të zbriten shpenzimet që janë kryer për qëllime të selisë së përhershme, përfshi shpenzimet ekzekutive dhe administrative të përgjithshme të kryera në këtë mënyrë, si në shtetin ku ndodhet selia e përhershme ashtu edhe gjatë.

4. Përderisa në një Shtet Kontraktues, në përcaktimin e fitimeve që do t'i atribuohen një selie të përhershme, është përdorur zakonisht metoda e ndarjes së fitimeve totale të sipërmarrjes në pjesët e veçanta të saj, dispozitat e paragrafit 2 nuk do ta pengojnë atë Shtet Kontraktues për të përcaktuar fitimet e tatueshme bazuar në një ndarje të tillë siç është vepruar zakonisht. Sidoqoftë, metoda e ndarjes duhet të jetë e tillë, që rezultati të jetë në përputhje me parimet që përmban ky nen.

5. Asnjë fitim nuk do t'i atribuohet një selie të përhershme thjesht për shkak të blerjes prej asaj selie të përhershme të mallrave për sipërmarrjen.

6. Për qëllime të paragrafëve të mëparshëm, fitimet që do t'i atribuohen selisë së përhershme do të përcaktohen me të njëjtën metodë çdo vit përderisa të mos ketë arsye të drejta dhe të mjaftueshme për të vepruar ndryshe.

7. Kur fitimet përfshijnë lloje të të ardhurave, që trajtohen veçmas në nene të tjera të kësaj Konvente, atëherë dispozitat e atyre neneve nuk do të influencohen nga dispozitat e këtij neni.

## Neni 8 Transporti ndërkombëtar ajror dhe detar

1. Fitimet nga operimi i anijeve dhe avionëve në trafikun ndërkombëtar do të taten vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet vendi i drejtimit efektiv të sipërmarrjes.

2. Nëse vendi i drejtimit efektiv të një sipërmarrjeje detare ndodhet në bordin e një anijeje, atëherë ajo do të konsiderohet e vendosur në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet porti i përhershëm ku qëndron anija ose, nëse nuk ekziston një port i tillë, në Shtetin Kontraktues, rezident i të cilit është operatori i anijes.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen gjithashtu ndaj fitimeve nga pjesëmarrja në një ortakëri, një biznes të përbashkët apo një agjenci ndërkombëtare transporti.

## Neni 9 Sipërmarrje të lidhura

1. Kur:

a) një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë direkt ose indirekt në menaxhimin, kontrollin apo kapitalin e një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues; ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë direkt ose indirekt në menaxhimin, kontrollin apo kapitalin e një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues dhe një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues,

dhe në secilin rast kushtet e vendosura ose të diktuar midis dy sipërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare apo financiare, që ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin midis sipërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim që do të realizohej nga njëra prej sipërmarrjeve, por që për shkak të këtyre kushteve nuk është realizuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj sipërmarrjeje dhe të tatonet normalisht.

2. Kur një Shtet Kontraktues përfshin në fitimet e një sipërmarrjeje të atij shteti — dhe i taton normalisht — fitime për të cilat një sipërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues është ngarkuar me tatim në atë shtet tjetër dhe fitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitime që do të ishin realizuar nga sipërmarrja e shtetit të përmendur në fillim nëse kushtet e vendosura midis dy sipërmarrjeve do të ishin ato që do të vendoseshin midis sipërmarrjeve të pavarura, atëherë ai shtet tjetër do të bëjë rregullimin e duhur në shumën e tatimit të ngarkuar mbi ato fitime. Në përcaktimin e këtij rregullimi do t'i kushtohet vëmendje edhe dispozitave të tjera të kësaj Konvente dhe autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese në rast nevojë do të konsultohen me njëri-tjetrin.

## Neni 10 Dividendët

1. Dividendët e paguar nga një kompani që është rezidente e një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatonen në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto dividendë mund të tatonen gjithashtu në Shtetin Kontraktues, rezidente e të cilit është kompania paguese e dividendëve, por tatimi i ngarkuar nuk do të kalojë:

a) 0 për qind të shumës bruto të dividendëve, nëse pronari përfitues është një kompani që zotëron direkt ose indirekt të paktën 50 për qind të kapitalit të kompanisë, kapitali i së cilës është tërësisht ose pjesërisht i ndarë në aksione për të cilat paguhen dividendë dhe ka investuar më shumë se 250 000\$ në kapitalin e kompanisë paguese të dividendëve;

b) 5 për qind të shumës bruto të dividendëve, nëse pronari përfitues është një kompani që zotëron direkt ose indirekt të paktën 25% të kapitalit të kompanisë paguese të dividendëve, kapitali i së cilës është tërësisht ose pjesërisht i ndarë në aksione;

c) 15 për qind të shumës bruto të dividendëve në të gjitha rastet e tjera.

3. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese me mirëkuptim reciprok duhet të zgjidhin mënyrën e aplikimit të paragrafit 2.

4. Dispozitat e paragrafit 2 nuk do të ndikojnë tatimin e kompanisë për fitimet prej të cilave janë paguar dividendët.

5. Termi “dividendë”, në kuptimin e përdorur në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga aksionet, përfshirë aksionet ose të drejtat “jouissance”, aksionet e minierave, aksionet e themelimit apo të drejta të tjera që nuk përbëjnë kërkesa borxhi, pjesëmarrjen në fitime, dhe të ardhurat nga të drejta të tjera korporative që i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga aksionet nga ligjet e shtetit, rezidente e të cilit është kompania që bën shpërndarjen.

6. Dispozitat e paragrafëve 1, 2 dhe 8 nuk do të aplikohen nëse pronari përfitues i dividendëve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues, rezidente e të cilit është kompania paguese e dividendëve, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty apo kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe zotërimi lidhur me të cilin janë paguar dividendët është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme apo bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 dhe 14, si të paraqitet rasti.

7. Kur një kompani që është rezidente e një Shteti Kontraktues realizon fitime ose të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, ai shtet tjetër mund të mos vendosë tatim mbi dividendët e paguar nga kompania, përveç kur këto dividendë i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues ose përderisa zotërimi, lidhur me të cilin janë paguar dividendët, është efektivisht i lidhur me një seli të përhershme apo me një bazë fikse të vendosur në atë shtet; subjekt i tatimit nuk do të jenë as fitimet e pashpërndara të kompanisë edhe nëse dividendët e paguar apo fitimet e pashpërndara konsistojnë tërësisht ose pjesërisht në fitime apo të ardhura të realizuara në atë shtet tjetër.

8. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, dividendët e paguar nga një kompani, kapitali i së cilës është i ndarë në aksione dhe e cila sipas ligjeve të një shteti është një rezidente e atij shteti, ndaj një individ që është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, mund të tatohen në Shtetin Kontraktues të përmendur në fillim në përputhje me ligjet e atij shteti, nëse ai individ- qoftë vetëm apo me bashkëshorten–apo me personat që ka lidhje në linjë direkte nga gjaku apo nga martesat, zotëron direkt ose indirekt të paktën 5 për qind të kapitalit të emetuar nga një grup (klasë) i veçantë aksionesh në atë kompani. Kjo dispozitë do të zbatohet vetëm nëse individ, të cilit i paguhen dividendët ka qenë një rezident i shtetit të përmendur në fillim në periudhën e 10 viteve të fundit përpara vitit në të cilin janë paguar dividendët dhe me kusht që, në kohën që ai u bë një rezident i shtetit tjetër, të plotësoheshin kushtet e përmendura më sipër, lidhur me pronësinë e aksioneve në kompaninë në fjalë.

Në rastet kur, sipas legjisllacionit të brendshëm të shtetit të përmendur në fillim, individit i është bërë një vlerësim tatimi, të cilit dividendët i janë paguar për tjetërsimin e aksioneve të sipërpërmendura, që është bërë në kohën e emigrimit të tij nga shteti i përmendur në fillim, dispozitat e mësipërme do të zbatohen vetëm për atë kohë sa vlerësimi ekziston si detyrim.

#### Neni 11 Interesat

1. Interesat e krijuara në një Shtet Kontraktues dhe që i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto interesa mund të tatohen gjithashtu në Shtetin Kontraktues në të cilin ato krijohen dhe në përputhje me ligjet e atij shteti, por nëse marrësi i interesave është pronari përfitues i interesave dhe tatimi i vendosur nuk do të kalojë:

a) 5 për qind të shumës bruto të interesave, në rastin e interesave të krijuara në një Shtet Kontraktues dhe që paguhen për një hua të dhënë nga një bankë apo çdo institucion tjetër financiar të Shtetit tjetër Kontraktues, përfshirë bankat e investimeve dhe bankat e kursimeve, dhe shoqëritë e sigurimit;

b) 10 për qind të shumës bruto të interesave në të gjitha rastet e tjera.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2, interesat e krijuar në një Shtet Kontraktues dhe që i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, i cili është pronari përfitues i tyre, do të tatohen vetëm në shtetin tjetër, nëse paguesi ose marrësi i interesave është qeveria e një Shteti Kontraktues, një nënndarje politike apo një autoritet lokal atje apo banka qendrore e një Shteti Kontraktues apo nëse interesat paguhen lidhur me një hua të dhënë, aprovuar, garantuar apo siguruar direkt ose indirekt nga qeveria e një Shteti Kontraktues, banka qendrore e një Shteti Kontraktues apo çdo agjenci apo instrument (përfshirë një institucion financiar) të zotëruar apo kontrolluar nga qeveria e një Shteti Kontraktues.

4. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok mënyrën e aplikimit të paragrafit 2.

5. Termi “interesa”, në kuptimin e përdorur në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga kërkesat e borxhit të çdo lloji, të siguruara ose jo me hipotekim, që e kanë ose jo të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e debitorit dhe në veçanti të ardhurat nga bonot e thesarit dhe letrat me vlerë e obligacionet shtetërore, përfshirë shpërblimet apo çmimet që u shtohen këtyre bonove të thesarit, letrave me vlerë dhe obligacioneve shtetërore. Gjykatat e ngarkuara për pagesa të vonuara nuk do të konsiderohen si interesa për qëllime të këtij neni.

6. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i interesave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin krijohen interesat, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryhen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe kërkesa e borxhit, lidhur me të cilin janë paguar interesat, është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen, sipas rastit, dispozitat e nenit 7 ose nenit 14.

7. Interesat do të konsiderohen se kanë lindur në një Shtet Kontraktues, kur paguesi është një rezident i atij shteti. Megjithatë, personi që paguan interesat, qoftë ose jo rezident i një shteti Kontraktues, ka në një Shtet Kontraktues një seli të përhershme apo një bazë fikse në lidhje me të cilën është dhënë huaja për të cilën paguhen interesat dhe këto interesa janë krijuar (paguar) nga kjo seli e përhershme apo bazë fikse, atëherë këto interesa do të konsiderohet se janë krijuar në shtetin në të cilin ndodhet selia e përhershme apo baza fikse.

8. Kur për shkak të marrëdhënieve të posaçme midis paguesit dhe pronarit përfitues ose midis të dyve dhe personave të tjerë, shumata e interesave, duke pasur parasysh kërkesën e borxhit për të cilën janë paguar, e kalon shumën që do të ishte rënë dakord midis paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm ndaj shumës së përmendur në fund. Në këtë rast, pjesa që kalon pagesën normale do të mbetet e tatueshme në përputhje me ligjet e secilit shtet Kontraktues, duke pasur parasysh edhe dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

## Neni 12 Honoraret

1. Honoraret (të ardhurat nga e drejta e autorit) që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë këto honorare mund të taten edhe në Shtetin Kontraktues në të cilin ato krijohen dhe në përputhje me ligjet e atij shteti, por nëse pronari përfitues i honorareve është një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, dhe tatimi i vendosur nuk do të kalojë 10 për qind të shumës bruto të honorareve. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok për mënyrën e aplikimit të këtij kufizimi.

3. Termi “honorare”, në kuptimin e përdorur në këtë nen, nënkupton pagesat e çdo lloji të marra si shpërblim për përdorimin apo të drejtën e përdorimit, të çdo të drejte autori në letërsi, për punime artistike apo shkencore, përfshirë filmat kinematografikë dhe filmat apo kasetat për transmetime radiofonike apo televizive, çdo patentë, markë tregtare, projekt apo model plan, proces apo formulë sekrete apo për informacione lidhur me eksperiencën industriale, tregtare apo shkencore.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i honorareve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin krijohen honoraret, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty apo kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur atje, dhe e drejta apo pasuria lidhur me të cilën paguhen honoraret është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme apo bazë fikse.

5. Honoraret do të konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues kur pagues është një rezident i atij shteti. Megjithatë, kur personi që paguan honoraret, qoftë ose jo rezident i një Shteti Kontraktues, ka një njërin Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose një bazë fikse, në lidhje me të cilën është krijuar detyrimi për pagimin e honorareve, dhe këto honorare kanë lindur në këtë seli të përhershme apo bazë fikse, atëherë këto honorare do të konsiderohet se janë krijuar në shtetin ku ndodhet selia e përhershme apo baza fikse.

6. Kur për shkak të lidhjeve të veçanta midis paguesit dhe pronarit përfitues dhe midis të dyve dhe personave të tjerë, shumata e honorareve, duke pasur parasysh përdorimin, të drejtën apo informacionin për të cilin ato janë paguar, e kalon shumën që do të ishte rënë dakord midis paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm ndaj shumës së përmendur në fund. Në këtë rast, pjesa që kalon pagesën normale do të mbetet e tatueshme në përputhje me ligjet e secilit Shtet Kontraktues, duke pasur parasysh edhe dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

## Neni 13

### Fitimet nga tjetërsimi i kapitalit

1. Fitimet e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme referuar në nenin 6 dhe të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme që bëjnë pjesë në pasuritë biznesore të një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues, ose i pasurive të luajtshme që i përkasin një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura, përfshirë edhe fitimet nga tjetërsimi i vetë selisë së përhershme (vetëm ose bashkë me sipërmarrjen) ose i bazës fikse, mund të taten në këtë shtet tjetër.

3. Fitimet e realizuara nga tjetërsimi i anijeve ose avionëve, që veprojnë në trafikun ndërkombëtar ose i pasurive të luajtshme që i përkasin veprimtarisë së këtyre anijeve ose avionëve do të taten vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet vendi i drejtimit efektiv të sipërmarrjes. Nëse vendi i drejtimit efektiv të një ndërmarrjeje të transportit detar është në bordin e një anijeje, atëherë, për qëllime të këtij paragrafi, ajo do të konsiderohet e vendosur në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet porti i anijes ose, nëse nuk ka një port të tillë, në Shtetin Kontraktues, rezident i të cilit është operuesi i anijes.

4. Kur një rezident i një Shteti Kontraktues zotëron më shumë se 5 për qind të aksioneve apo të drejta të tjera në një kompani pasuria e së cilës konsiston, direkt ose indirekt, kryesisht në pasuri të paluajtshme të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues, fitimet nga tjetërsimi i këtyre aksioneve mund të taten në atë Shtet tjetër Kontraktues.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo pasurie të ndryshme nga ato të referuara në paragrafët e mësipërm do të taten vetëm në Shtetin Kontraktues, rezident i të cilit është tjetërsuesi.

6. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 5, një Shtet Kontraktues mundet që, në përputhje me ligjet e tij të brendshme, përfshirë interpretimin e termit “tjetërsim”, të vendosë një tatim mbi fitimet e realizuara nga një individ, që është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, nga tjetërsimi i aksioneve në të drejta “jouissance” apo kërkesa borxhi mbi një kompani, kapitali i së cilës është i ndarë në aksione dhe e cila, sipas ligjeve të Shtetit Kontraktues të përmendura në fillim, është rezidente e atij shteti dhe nga tjetërsimi i pjesës së të drejtave që u takojnë atyre aksioneve, aksioneve “jouissance” ose kërkesave të borxhit, nëse ai individ- qoftë vetëm apo me bashkëshorten apo me personat që ka lidhje në linjë direkte nga gjaku apo nga martesja, zotëron direkt ose indirekt të paktën 5 për qind të kapitalit të emtuar nga një grup (klasë) i veçantë aksionesh në atë kompani. Kjo dispozitë do të zbatohet vetëm nëse individi, i cili ka realizuar fitimet, ka qenë një rezident i shtetit të përmendur në fillim në periudhën e 10 viteve të fundit përpara vitit në të cilin janë realizuar fitimet dhe me kusht që në kohën që ai u bë një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, të plotësohen kushtet e përmendura më sipër lidhur me pronësinë e aksioneve në kompaninë në fjalë.

Në rastet kur, sipas legjislacionit të brendshëm të shtetit të përmendur në fillim, individit i është bërë një vlerësim tatimi lidhur me tjetërsimin e aksioneve të sipërpërmendura, tjetërsim që është bërë në kohën e emigrimit të tij nga shteti i përmendur në fillim, dispozitat e mësipërme do të zbatohen vetëm për atë kohë sa vlerësimi ekziston si detyrim.

## Neni 14

### Shërbimet personale të pavarura

1. Të ardhurat e realizuara nga një individ që është rezident i një Shteti Kontraktues, lidhur me shërbimet profesionale apo me shërbime të tjera të ngjashme të një karakteri të pavarur, do të taten vetëm në atë shtet, përveç në rrethanat e mëposhtme, kur këto të ardhura mund të taten gjithashtu edhe në Shtetin tjetër Kontraktues:

a) nëse ai ka një bazë fikse rregullisht në dispozicion të tij në Shtetin tjetër Kontraktues me qëllim kryerjen e aktiviteteve të tij, në atë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i atribuohet asaj baze fikse mund të tatohet në atë shtet tjetër;ose

b) nëse qëndrimi i tij në Shtetin tjetër Kontraktues është për një periudhë që në total arrin ose i kalon 183 ditë në çdo periudhë 12-mujore që fillon ose përfundon në vitin kalendarik përkatës; në atë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave e realizuar nga aktivitetet e tij të realizuara në atë shtet tjetër mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Termi “shërbime profesionale” përfshin veçanërisht aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, edukative apo të mësimdhënies, si edhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, dentistëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve dhe kontabilistëve.

#### Neni 15

### **Të ardhurat nga punësimi**

1. Pa cenuar dispozitat e neneve 16, 18, 19 dhe 20, rrogat, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme të realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga punësimi do të tatohen vetëm në atë shtet, përveç kur puna është ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse puna është ushtruar në këtë mënyrë, këto të ardhura të realizuara në këtë mënyrë mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, shpërblimet e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues lidhur me punësimin e ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues do të tatohen vetëm në shtetin e përmendur në fillim, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) përfituesi është prezent në shtetin tjetër për një periudhë apo periudha që në total nuk i kalojnë 183 ditë në çdo periudhë 12-mujore që fillon ose përfundon në vitin fiskal përkatës;

b) shpërblimi paguhet nga ose në emër të një punëdhënësi që nuk është rezident i shtetit tjetër;

c) shpërblimi nuk ka lindur nga një seli e përhershme apo bazë fikse që punëdhënësi ka në shtetin tjetër.

3. Pavarësisht nga dispozitat e këtij neni, të ardhurat e realizuara, lidhur me punësimin e ushtruar në bordin e një anijeje apo avioni që operojnë në trafikun ndërkombëtar, mund të tatohen në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet vendi i drejtimi efektiv të sipërmarrjes.

#### Neni 16

### **Shpërblimet e drejtorëve**

1. Pagesat e drejtorëve apo shpërblime të tjera të ngjashme të realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues në pozicionin e tij si anëtar i bordit të drejtorëve apo një organi të ngjashëm i një kompanie që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Kur pagesat e përmendura në paragrafin 1 realizohen nga një person që ushtron aktivitete të një karakteri të rregullt dhe substancial në një seli të përhershme të vendosur në një shtet, jo në shtetin në të cilin kompania është rezidente dhe pagesa është e reduktueshme në përcaktimin e fitimit të tatueshëm të asaj selie të përhershme, atëherë, pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, deri në masën që pagesat janë të reduktueshme, këto të ardhura do të tatohen në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet selia e përhershme.

#### Neni 17

### **Artistët dhe sportistët**

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 14 dhe 15, të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues si një argëtues, si artist teatri, kinematografie, radio apo televizioni ose muzikant apo sportist, nga aktivitetet e tij personale si të tilla të ushtruara në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Kur të ardhura, lidhur me aktivitetet personale të ushtruara nga një artist apo sportist nga veprimtari të tilla realizohen jo direkt nga artisti apo sporti, por nga një person tjetër, këto të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 14 dhe 15, do të taten në Shtetin Kontraktues në të cilin ushtrohen aktivitetet e artistit apo sportistit.

#### Neni 18

### **Pensionet, pagesat periodike dhe pagesat e sigurimeve shoqërore**

1. Pa cenuar dispozitat e paragrafit 2 të nenit 19, pensionet dhe pagesa të tjera të ngjashme që i paguhen një rezidenti të një Shteti Kontraktues lidhur me punën e tij në të kaluarën, si edhe pagesat periodike që i paguhen një rezidenti të një Shteti Kontraktues, do të taten vetëm në atë shtet. Çdo pension dhe pagesë tjetër paguar në bazë të dispozitave të sistemit të sigurimeve shoqërore të një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues do të taten vetëm në atë shtet tjetër.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, pensionet apo shpërblime të tjera të ngjashme (annuities) apo çdo pension dhe pagesë tjetër e bërë në bazë të dispozitave të sistemit të sigurimeve shoqërore të një Shteti Kontraktues, mund të taten gjithashtu në Shtetin Kontraktues ku ato krijohen, në përputhje me ligjet e atij shteti:

a) në qoftë se dhe përderisa e drejta për këtë pensionet apo shpërblim tjetër të ngjashëm apo pagesë periodike është përjashtuar nga tatimi në Shtetin Kontraktues ku është krijuar, ose kontributet përkatëse të pensionit, shpërblimit të ngjashëm apo pagesës periodike të bëra në skemën e pensionit apo kompaninë e sigurimit janë reduktuar (njohur si shpenzim për efekt tatimi) në të kaluarën, kur janë llogaritur të ardhurat e tatueshme në atë shtet apo të kualifikuara për lehtësi të tjera tatimore në atë shtet;

b) në qoftë se dhe përderisa ky pension apo pagesë tjetër e ngjashme apo pagesë periodike nuk është tatuar në Shtetin Kontraktues ku është rezident marrësi, me tarifën që përgjithësisht aplikohet ndaj të ardhurave nga punësimi, apo më pak se 90 për qind të shumës bruto të pensionit apo shpërblimit të ngjashëm apo pagesës periodike është tatuar;

c) nëse shuma bruto e pensionit dhe pagesave të tjera të ngjashme dhe pagesë periodike, dhe çdo pension apo shpërblim tjetër i paguar sipas dispozitave të një sistemi të sigurimeve shoqërore të një Shteti Kontraktues, në çdo vit kalendarik e kalon shumën prej 20 000 eurosh.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, nëse ky pension apo shpërblim tjetër i ngjashëm nuk është periodik në natyrë dhe paguhet lidhur me punësimin në të kaluarën në Shtetin tjetër Kontraktues dhe është paguar përpara datës në të cilin fillon pensioni, ose nëse pagesa totale e njehershme është bërë në vend (në këmbim) të së drejtës për një pagesë periodike para datës në të cilin fillon pagesa periodike, pagesa e kësaj shume totale mund të taten gjithashtu në Shtetin Kontraktues ku krijohet.

4. Një pension apo shpërblim tjetër i ngjashëm apo pagesë periodike konsiderohet të jetë krijuar në një Shtet Kontraktues, në qoftë se dhe përderisa kontributet apo pagesat e lidhura me pensionin apo shpërblime të tjera të ngjashme apo pagesa periodike, apo të drejtat e marra nga to, janë njohur për efekt tatimi në atë shtet. Transferimi i një pensioni nga një fond pensionesh apo një kompani sigurimi e njërit Shtet Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues nuk do të kufizojë të drejtat tatimore të shtetit të përmendur në fillim sipas dispozitave të këtij neni.

5. Autoritetet kompetente të shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok për mënyrën e aplikimit të paragrafit 2. Ato gjithashtu do të vendosin për detajet që duhet të paraqesë një rezident i një Shteti Kontraktues me qëllim aplikimin e duhur të Konventës në Shtetin tjetër Kontraktues, sidomos për të vendosur nëse kushtet e dhëna në nënparagrafët a, b dhe c, të paragrafit 2 janë plotësuar.

6. Termi “pagesë periodike” nënkupton një shumë fikse të pagueshme periodikisht në kohë të caktuara gjatë jetës ose gjatë një periudhe kohe të specifikuar apo të paracaktuar në bazë të një detyrimi për kryerjen e pagesave (kontributeve) në këmbim të këtij shpërblimi adekuat në para ose pasuri me vlerë monetare.

7. Nëse dhe në ç'masë një pension apo shpërblim i ngjashëm mbulohet nga ky nen apo nga neni 19, kjo përcaktohet nga natyra e punësimit në të kaluarën, si private apo qeveritare, gjatë së cilës e drejta e asaj pjese të pensionit apo pagese të ngjashme është ndërtuar (krijuar).

#### Neni 19

#### **Shërbimet qeveritare**

1. a) Rrogat dhe pagat, si dhe shpërblime të tjera të ngjashme, të ndryshme nga pensionet, të paguara nga një Shtet Kontraktues apo një nënndarje politike apo një autoritet lokal atje, një individ lidhur me shërbimet e kryera për atë shtet, nënndarje apo autoritet mund të tatohen në atë shtet.

b) Megjithatë, këto rroga, paga apo shpërblime të tjera do të tatohen vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse shërbimet janë kryer në atë shtet dhe individ është një rezident i atij shteti, i cili (individ):

i) është nënshtetas i atij shteti; ose

ii) nuk është bërë rezident i atij shteti vetëm për qëllim të kryerjes së shërbimeve.

2. a) Çdo pension i paguar nga apo prej fondeve të krijuara nga një Shtet Kontraktues, një nënndarje politike apo një autoritet lokal atje, një individ lidhur me shërbimet e kryera atij shteti apo nëndarje apo autoriteti lokal mund të tatohet në atë shtet.

b) Megjithatë, këto pensione mund të tatohen vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse individ është një rezident dhe një nënshtetas i atij shteti.

3. Dispozitat e neneve 15, 16 dhe 18 do të aplikohen ndaj rrogave, pagave dhe shpërblimeve të tjera të ngjashme dhe ndaj pensioneve lidhur me shërbimet e kryera në lidhje me një biznes të ushtruar nga një Shtet Kontraktues, një nënndarje politike apo një autoritet lokal atje.

#### Neni 20

#### **Studentët dhe specialistët**

1. Çdo pagesë e marrë nga një student apo një specialist biznesi, i cili është ose ishte menjëherë përpara vajtjes në Shtet Kontraktues një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues dhe që është prezent në shtetin e përmendur në fillim vetëm për qëllim arsimimi apo trajnimi, për qëllim të jetesës së tij, arsimimit apo trajnimit nuk do të tatohet në atë shtet, me kusht që të tilla pagesa lindin nga burime jashtë atij shteti.

2. Lidhur me grantet, bursat dhe të ardhurat nga punësimi që nuk mbulohen nga paragrafi 1, që një student apo specialist i përshkruar në paragrafin 1, do të marrë si shtesë, gjatë këtij arsimimi apo trajnimi do të gëzojë të njëjtat përjashtime, lehtësi apo reduktime lidhur me tatimet njëilloj si rezidentët e shtetit ku ai ka vajtur.

#### Neni 21

#### **Të ardhura të tjera**

1. Zëra të të ardhurave të një rezidenti të një Shteti Kontraktues kudo që të krijohen, që nuk mbulohen nga nenet e mëparshme të kësaj Konvente do të tatohen vetëm në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen ndaj të ardhurave, të ndryshme nga të ardhurat nga pasuria e paluajtshme që përcaktohen në paragrafin 2 të nenit 6, nëse përfituesi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty apo kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur aty, dhe e drejta apo pasuria lidhur me të cilën janë paguar të ardhurat është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme apo bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose 14, si të paraqitet rasti.

Neni 22  
**Kapitali**

1. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të paluajtshme referuar të nenin 6, i zotëruar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe i vendosur në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të luajtshme, që bëjnë pjesë në pasuritë biznesore të një selie të përhershme, që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues apo nga pasuri të luajtshme që i përkasin një baze fikse, që një rezident i një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues me qëllim kryerjen e shërbimeve personale të pavarura, mund të tatohet në atë shtet tjetër.

3. Kapitali i përfaqësuar nga anijet dhe avionët, që operojnë në trafikun ndërkombëtar, dhe nga pasuri të luajtshme, që i përkasin veprimtarisë së këtyre anijeve dhe avionëve, do të tatohet vetëm në Shtetin Kontraktues ku ndodhet vendi i drejtimit efektiv të sipërmarrjes.

4. Të gjithë elementet e tjera të kapitalit të një rezidenti të një Shteti Kontraktues do të tatohen vetëm në atë shtet.

**KAPITULLI IV**  
**ELIMINIMI I TATIMIT TË DYFISHTË**

Neni 23  
**Eliminimi i tatimit të dyfishtë**

1. Në Holandë tatimi i dyfishtë do të eliminohet si vijon:

a) Kur aplikon një tatim mbi rezidentët e vet, Holanda mund të përfshijë në bazën mbi të cilën aplikohet ky tatim, zëra të të ardhurave apo të kapitalit, të cilat, në bazë të dispozitave të kësaj Konvente, mund të tatohen në Shqipëri.

b) Megjithatë, kur një rezident i Holandës realizon zëra të të ardhurave apo të kapitalit që në përputhje me nenin 6, nenin 7 paragrafin 6 të nenit 10, paragrafin 6 të nenin 11, paragrafin 4 të nenit 12, paragrafët 1 dhe 2 të nenit 13, paragrafin 1 të nenit 14, paragrafin 1 të nenit 15, paragrafin 2 të nenit 18, paragrafët 1 (nënparagrafi a dhe 2 (nënparagrafi a) të nenit 19, paragrafin 2 të nenit 21 dhe paragrafët 1 dhe 2 të nenit 22 të kësaj Konvente mund të tatohen në Shqipëri dhe janë përfshirë në bazën e referuar në paragrafin 1, Holanda do të përjashtojë këto zëra të ardhurash apo kapitali duke lejuar reduktimin e tatimit të saj. Ky reduktim do të llogaritet në përputhje me dispozitat e legjislacionit holandez për shmangien e tatimit të dyfishtë. Për këtë qëllim, zërat në fjalë të të ardhurave dhe kapitalit do të konsiderohen të jenë përfshirë në shumën e zërave të të ardhurave apo kapitalit që janë përjashtuar nga tatimi holandez sipas atyre dispozitave.

c) Holanda gjithashtu do të lejojë një reduktim (zbritje) nga tatimi holandez të llogaritur për zërat e të ardhurave, të cilat të përputhje me paragrafin 2 (nënparagrafët b dhe c) të nenit 10, paragrafi 2 i nenit 11, paragrafi 2 i nenit 12, neni 16, neni 17 dhe paragrafët 2, 4, 5 dhe 6 të nenit 23 A të kësaj Konvente mund të tatohen në Shqipëri në masën që këto zëra janë përfshirë në bazën referuar në paragrafin 1. Shuma e këtij reduktimi do të jetë e barabartë me tatimin e paguar në Shqipëri mbi këto zëra të ardhurash, por në rast se dispozitat e ligjit holandez për shmangien e tatimit të dyfishtë e parashikojnë një gjë të tillë, nuk do ta kalojë shumën e reduktimit që do të lejohej nëse zërat e të ardhurave të përfshira në këtë mënyrë do të ishin të vetmet zëra të të ardhurave që janë përjashtuar nga tatimi holandez në dispozitat e legjislacionit holandez për shmangien e tatimit të dyfishtë.

Ky nënparagraf, prej këtij e tutje, nuk do të kufizojë lejimin (njohjen) e siguruar nga dispozitat e legjislacionit holandez për shmangien e tatimit të dyfishtë, por vetëm përsa i përket llogaritjes së shumës së reduktimit të tatimit holandez në lidhje me mbledhjen (shumën) e të ardhurave nga dy a më shumë vende.

d) Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2, Holanda do të lejojë një reduktim nga tatimi holandez të tatimit të paguar në Shqipëri mbi zëra të të ardhurave, të cilat, sipas nenit 7 paragrafit 6 të nenit 10, paragrafit 6 të nenit 11, paragrafit 4 të nenit 12, nenit 14 dhe paragrafit 2 të nenit 21 të kësaj Konvente mund të taten në Shqipëri, deri në masën që këto zëra janë përfshirë në bazën tatimore të referuar në paragrafin 1, në qoftë se dhe përderisa Holanda, sipas dispozitave të legjislacionit holandez për shmangien e tatimit të dyfishtë, lejon një reduktim nga tatimi holandez të tatimit të vjelur në një vend tjetër mbi këto zëra të të ardhurave. Për llogaritjen e këtij rduktimi do të aplikohen dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni.

2. Në Shqipëri tatimi i dyfishtë do të eliminohet si vijon:

a) Kur një rezident i Shqipërisë realizon të ardhura ose zotëron kapitale, të cilat, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente mund të taten në Holandë, Shqipëria do të lejojë:

i) një reduktim nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti të një shume të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në Holandë;

ii) një reduktim nga tatimi shqiptar mbi kapitalin e atij rezidenti, të një shume të barabartë me tatimin mbi kapitalin të paguar në Holandë.

Megjithatë, në asnjë rast, ky reduktim nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit shqiptar mbi të ardhurat apo mbi kapitalin të llogaritur para dhënies së reduktimit, që i atribuohet, sipas rastit, të ardhurave apo kapitalit që mund të taten në Holandë.

b) Kur, në përputhje me dispozitat e Konventës, të ardhurat e realizuara apo kapitali i zotëruar nga një rezident i Shqipërisë është i përjashtuar nga tatimi në Shqipëri, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi të ardhurat e mbetura apo kapitalin e mbetur të këtij rezidenti, Shqipëria mund të marrë në konsideratë të ardhurat apo kapitalin e përjashtuar.

## KAPITULLI V DISPOZITA TË VEÇANTA

### Neni 23A **Aktivite në det (përtej bregut)**

1. Dispozitat e këtij neni do të aplikohen pavarësisht nga çdo dispozitë tjetër e kësaj Konvente.

2. Një person që është rezident i një Shteti Kontraktues dhe ushtron aktivitete në det në Shtetin tjetër Kontraktues në lidhje me zbulimin dhe shfrytëzimin e tabanit detar, nëntokës dhe burimeve të tyre natyrore të ndodhura në shtetin tjetër, pa cenuar dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni, do të konsiderohet që në lidhje me ato aktivitete ai person ushtron biznes në atë shtet tjetër nëpërmjet një selie të përhershme apo baze fikse të vendosur aty.

3. Dispozitat e paragrafit 2 nuk do të zbatohen kur aktivitetet janë ushtruar për një periudhë që në total nuk i kalon 30 ditë në çdo periudhë 12-mujore. Megjithatë, për qëllime të këtij paragrafi:

a) aktivitetet e ushtruara nga një sipërmarrje e lidhur me një sipërmarrje tjetër do të konsiderohen si të ushtruara nga sipërmarrja me të cilën ajo është e lidhur nëse aktivitetet në fjalë janë thelbësisht të njëjta me ato të ushtruara nga sipërmarrja e përmendur në fund;

b) dy sipërmarrje do të konsiderohen të lidhura nëse njëra kontrollohet direkt ose indirekt nga tjetra, ose të dyja kontrollohen direkt ose indirekt nga një person apo persona të tretë.

4. Fitimet e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga transportimi i furnizimeve apo i personelit në një vend pune (alokim) në det apo midis alokimeve të ndryshme, kur aktivitetet në lidhje me zbulimin dhe shfrytëzimin e tabanit detar, nëntokës dhe burimeve të tyre natyrore kryhen në një Shtet Kontraktues, ose nga operimi i rimorkiatorëve dhe anijeve të tjera që ndihmojnë në këto aktivitete, do të taten vetëm në Shtetin Kontraktues, rezidente e të cilit është sipërmarrja. Kjo dispozitë nuk do të zbatohet nëse anija ose avioni operohet nga një seli e përhershme në kuptimin e nenit 5 të kësaj Konvente ose aktivitetet vazhdojnë për më tepër se 6 muaj në çdo periudhë 12-mujore.

5. a) Në bazë të dispozitave të nënparagrafit b të këtij paragrafi, rrogat, pagat dhe shpërblime të ngjashme të realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga një punësim i lidhur me zbulimin dhe shfrytëzimin e tabanit detar, nëntokës dhe burimeve të tyre natyrore të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues, mundet që, deri në masën që këto punë janë realizuar në det në atë shtet tjetër, të taten në atë shtet tjetër. Megjithatë, këto shpërblime do të taten vetëm në shtetin e përmendur në fillim, nëse punësimi ushtrohet në det për një punëdhënës që nuk është rezident i shtetit tjetër dhe për një periudhë apo periudha që nuk i kalojnë 30 ditë në çdo periudhë 12-mujore.

b) Rrogat, pagat dhe shpërblime të ngjashme të realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues për punën e ushtruar në bordin e një anijeje apo avioni që operon në transportimin e furnizimeve apo personelit në një vend pune (platformë) në det, ose midis vendeve të punës, kur aktivitetet lidhur me zbulimin dhe shfrytëzimin e tabanit detar, nëntokës dhe burimeve të tyre natyrore janë ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues, ose lidhur me një punësim të ushtruar në rimorkiatorët apo anijet e tjera që operojnë në ndihmë të këtyre aktiviteteve, mund të taten në Shtetin Kontraktues, rezidente e të cilit është sipërmarrja që ushtron këto aktivitete. Kjo dispozitë nuk do të zbatohet nëse anija ose avioni operohet nga një seli e përhershme në kuptimin e nenit 5 të kësaj Konvente ose aktivitetet vazhdojnë për më tepër se 6 muaj në çdo periudhë dymbëdhjetëmuajore.

6. Fitimet e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi:

a) i të drejtave të zbulimit apo shfrytëzimit;

b) i pasurisë së vendosur në Shtetin tjetër Kontraktues dhe të përdorur në lidhje me zbulimin e tabanit detar, nëntokës dhe burimeve të tyre natyrore të ndodhura në atë shtet tjetër;

c) i aksioneve, vlera e të cilave ose pjesa më e madhe e vlerës së të cilave rrjedh direkt ose indirekt nga të drejta të tilla apo të drejta dhe pasuri të tilla të marra së bashku, mund të taten në atë shtet tjetër.

Në këtë paragraf shprehja “të drejta të zbulimit dhe të shfrytëzimit” nënkupton të drejta ndaj asetëve që prodhohen nga zbulimi apo shfrytëzimi i tabanit detar, nëntokës dhe burimeve të tyre natyrore në Shtetin tjetër Kontraktues, përfshirë të drejta ndaj interesave apo përfitimeve nga asetë të tilla.

## Neni 24

### Mosdiskriminimi

1. Shtetasit e një Shteti Kontraktues nuk do t'i nënshtrohen ndonjë tatimi apo kërkesë të lidhur me të që të jenë të ndryshme apo më të rënda sesa tatimet apo kërkesa të lidhura me to, të cilave u nënshtrohen ose mund t'u nënshtrohen nënshtetasit e atij shteti tjetër në rrethana të njëjta, në veçanti lidhur me rezidencën. Kjo dispozitë, pavarësisht nga dispozitat e nenit 1, do të zbatohet gjithashtu ndaj personave që nuk janë rezidentë të njërit apo asnjërit nga Shtetet Kontraktuese.

2. Tatimi i një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues nuk do të jetë më pak i favorshëm në këtë shtet tjetër sesa tatimi i vjelur ndaj sipërmarrjeve të këtij shteti tjetër që ushtrojnë aktivitete të njëjta. Kjo dispozitë nuk do të merret si detyrim i njërit Shtet Kontraktues për t'i garantuar rezidentëve të Shtetit tjetër Kontraktues ndihma, lehtësime personale apo reduktime personale për qëllime tatimore që i garanton rezidentëve të shtetit të vet për gjendjen civile dhe përgjegjësitë familjare që ata kanë.

3. Përrjashtuar rastet kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 në nenin 9, paragrafit 8 të nenit 11 ose paragrafit 6 të nenit 12, interesat, honoraret dhe shpërblime të tjera të paguara nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj sipërmarrjeje, do të jenë të reduktueshme nën të njëjtat kushte njëllor sikur ato t'i paguheshin një rezidenti të shtetit të përmendur në fillim. Në mënyrë të ngjashme, çdo borxh i një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të kapitalit të tatueshëm të kësaj sipërmarrjeje, do të jetë i

reduktueshëm nën të njëjtat kushte njëloj sikur sipërmarrja të kishte kontraktuar me një rezident të Shtetit të përmendur në fillim.

4. Sipërmarrjet e një Shteti Kontraktues, kapitali i të cilave është totalisht ose pjesërisht i zotëruar apo kontrolluar, direkt ose indirekt, nga një ose më shumë rezidentë të Shtetit tjetër Kontraktues, nuk do të jenë në shtetin e përmendur në fillim subjekt i ndonjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të, që të jetë i ndryshëm ose më i rëndë sesa tatimi ose kërkesat e lidhura me të, të cilave i nënshtrohen ose mund t'i nënshtrohen sipërmarrje të tjera të ngjashme të shtetit të përmendur në fillim.

5. Kontributet e paguara nga ose në emër të një individi që është rezident i një Shteti Kontraktues për një plan pensionesh që është i njohur për qëllime tatimore në shtetin e përmendur në fillim si një kontribut i paguar për një plan (skemë) pensioni që njihet për qëllime tatimore në atë shtet të përmendur në fillim, me kusht që:

a) ky individ ka kontribuar për një plan të tillë pensionesh përpara se të bëhej një rezident i shtetit të përmendur në fillim; dhe

b) autoriteti kompetent i shtetit të përmendur në fillim bie dakord se plani i pensioneve i korrespondon një plani pensioni të njohur për qëllime tatimore nga ai shtet.

Për qëllime të këtij paragrafi, termi “plan pensionesh” përfshin një plan pensionesh të krijuar nën një sistem publik të sigurimeve shoqërore.

6. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 2, dispozitat e këtij neni do të zbatohen ndaj tatimeve të çdo lloji dhe përshkrimi. Megjithatë ky paragraf nuk zbatohet ndaj tatimeve të vjelura lidhur me zbatimin e shërbimeve.

#### Neni 25

### **Procedura e mirëkuptimit reciprok**

1. Kur një person mendon se veprimet e njërit apo të dy Shteteve Kontraktuese e rëndojnë apo do ta rëndojnë atë me tatime që nuk janë në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, pavarësisht nga rrugëzgjdhjet e siguruara nga legjislacioni i brendshëm i këtyre shteteve, ai mund t'i paraqesë rastin e tij autoritetit kompetent të Shtetit Kontraktues rezident i të cilit ai është, ose nëse çështja ka të bëjë me paragrafin 1 të nenit 24, ai mund t'i paraqesë atë Shtetit Kontraktues nënshtetas i të cilit ai është. Çështja duhet të paraqitet brenda tre vjetëve nga njoftimi i parë lidhur me veprimin që ka rezultuar në tatimin që nuk është në përputhje me dispozitat e Konventës.

2. Autoriteti kompetent, nëse kërkesa i duket e justifikuar dhe ai vetë nuk e ka të mundur arritjen e një zgjidhjeje të kënaqshme, do të përpiqet ta zgjidhë çështjen me mirëkuptim reciprok me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, me synim shmangien e tatimit që nuk është në përputhje me Konventën. Çdo marrëveshje e arritur do të zbatohet pavarësisht nga limitet kohore të përcaktuara nga ligji i brendshëm i secilit prej Shteteve Kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të përpiqen që me mirëkuptim reciprok të zgjidhin çdo vështirësi apo dyshim që lind nga interpretimi apo zbatimi i Konventës. Ato gjithashtu mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet kur një gjë e tillë nuk sigurohet nga Konventa.

4. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të komunikojnë me njëri-tjetrin direkt për arritjen e mirëkuptimit në kuptimin e paragrafëve të mësipërm.

5. Nëse ndonjë problem apo dyshim lidhur me interpretimin apo aplikimin e Konventës nuk mund të zgjidhet nga autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese nëpërmjet procedurës së mirëkuptimit reciprok në bazë të paragrafëve të mëparshëm të këtij neni brenda një periudhe prej dy vitesh pas daljes së këtij problemi, me kërkesën e njërit prej Shteteve Kontraktuese, rasti (konflikti) mund të kalohet për arbitrazh, por vetëm pasi të jenë shfrytëzuar plotësisht procedurat sipas paragrafëve 1 deri 4 të këtij neni dhe me kusht që tatimpaguesi ose tatimpaguesit e përfshirë bien dakord me shkrim se do të zbatojnë vendimin e bordit të arbitrazhit. Bordi i arbitrazhit do të krijohet nga autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të bien dakord për bordin e arbitrazhit dhe do ta instruktojnë atë lidhur me rregullat

specifike të procedurave, siç është caktimi i një kryetari, procedurat për marrjen e vendimit dhe vendosja e kufijve kohorë.

Vendimi i bordit të arbitrazhit për rastin përkatës është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga të dy Shtetet Kontraktuese dhe nga tatimpaguesi apo tatimpaguesit që përfshihen në atë rast.

#### Neni 26

### **Shkëmbimi i informacionit**

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të shkëmbejnë informacionet e nevojshme për zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente ose të ligjeve të brendshme të Shteteve Kontraktuese lidhur me tatimet e çdo lloji dhe përshkrimi të vëna në emër të Shteteve Kontraktuese, nënndarjeve politike të tyre apo autoriteteve lokale, përderisa ato tatime nuk janë në kundërshtim me Konventën. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2. Çdo informacion i marrë nga një Shtet Kontraktues do të trajtohet si sekret, në të njëjtën mënyrë si informacioni i marrë nën legjislacionin e brendshëm të atij shteti dhe do t'i serviret vetëm personave apo autoriteteve (përfshirë gjykatat dhe organet administrative) të përfshira në llogaritjen apo mbledhjen e tatimeve, me imponimin e ndjekjet lidhur me shkeljet tatimore apo lidhur me ankesat ndaj tatimeve të referura në fjalën e parë. Këto persona apo autoritete do ta përdorin informacionin vetëm për të tilla qëllime. Ato mund ta servirin informacionin në procedurat apo vendimet gjyqësore.

2. Shtetet Kontraktuese mund t'i japin bordit të arbitrazhit të krijuar sipas dispozitave të paragrafit 5 të nenit 25, informacionet e nevojshme për ushtrimin e procedurës së arbitrazhit. Kjo dhënie informacioni do të jetë në përputhje me dispozitat e nenit 28. Anëtarët e bordit të arbitrazhit duhet të respektojnë kufizimet lidhur me zbulimin e informacioneve të përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni, lidhur me çdo informacion të marrë për këtë qëllim.

#### Neni 27

### **Asistencë për mbledhjen**

1. Shtetet Kontraktuese bien dakord t'i ofrojnë reciprokisht njëri-tjetrit asistencë dhe mbështetje me synim mbledhjen e tatimeve ndaj të cilave zbatohet kjo Konventë dhe çdo rritje, vlerësim shtesë, interes dhe kosto që i përkasin atyre tatimeve, në përputhje me ligjet e tyre përkatëse tatimore dhe praktikat administrative.

2. Me kërkesë të Shtetit Kontraktues aplikues, Shteti Kontraktues të cilit i kërkohet asistencë (Shteti zbatues) do të trajtojë kërkesat për mbledhje tatimi të shtetit të përmendur në fillim në përputhje me legjislacionin dhe praktikat administrative në bazë të të cilave ai mbledh tatimet e veta. Sidoqoftë, këto kërkesa nuk gëzojnë ndonjë prioritet në Shtetin zbatues dhe në atë shtet nuk mund të aplikohet burgimi për borxhet e tatimpaguesve. Shteti zbatues nuk është i detyruar të ndërmarrë masa ekzekutive që nuk parashikohen në legjislacionin e Shtetit aplikues.

3. Dispozitat e paragrafit 2 do të zbatohen vetëm ndaj kërkesave që formojnë subjektin e një instrumenti që lejon masat shtrënguese në Shtetin aplikues dhe, me përjashtim të rasteve ku bihet dakord ndryshe ndërmjet autoriteteve kompetente, të cilat raste nuk janë kontestuar. Megjithatë, kur kërkesat lidhen me një detyrim tatimor të një personi që nuk është rezident në Shtetin aplikues, do të zbatohet vetëm paragrafi 2, me përjashtim të rasteve kur është rënë dakord ndryshe nga autoritetet Kontraktuese, në të cilat raste kërkesa nuk është më e kontestueshme.

4. Shteti zbatues nuk do të jetë i detyruar të pranojë kërkesën:

a) në qoftë se Shteti aplikues nuk i ka ndjekur të gjitha mënyrat dhe mjetet e mundshme në territorin e tij, përveç rasteve kur përdorimi i mjeteve të tilla do të shkaktonte vështirësi tepër të mëdha;

b) në qoftë se dhe përderisa ai e konsideron kërkesën për mbledhje tatimi të jetë në kundërshtim me dispozitat e kësaj Konvente apo të çdo marrëveshjeje tjetër në të cilën të dy shtetet janë palë.

5. Instrumentet që lejojnë aplikimin e masave shtrënguese në Shtetin aplikues, kur janë të drejta dhe në përputhje me dispozitat në fuqi në Shtetin zbatues, do të pranohen, njihen, plotësohen apo zëvendësohen sa më shpejt që të jetë e mundur pas datës së marrjes së kërkesës për asistencë nga një instrument që lejon aplikimin e masave shtrënguese në Shtetin zbatues.

6. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese me mirëkuptim të përbashkët do të përcaktojnë rregullat për zbatimin e këtij neni.

Neni 28

### **Kufizimi i fushëveprimit të neneve 26 dhe 27**

Në asnjë rast dispozitat e neneve 26 dhe 27 nuk do të merren si dispozita detyruese të njërit Shtet Kontraktues:

a) për të zbatuar masa administrative në kundërshtim me ligjet dhe praktikat administrative të tij apo të Shtetit tjetër Kontraktues;

b) për të dhënë informacione që nuk lejohen të jepen sipas ligjeve apo praktikës normale të administratës së vet tatimore apo asaj të Shtetit tjetër Kontraktues;

c) për të dhënë informacione që do të zbulonin çdo sekret prodhues, biznesor, industrial, komercial apo profesional apo informacione, zbulimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me rendin publik.

Neni 29

### **Anëtarët e misioneve diplomatike dhe konsullore**

Dispozitat e kësaj Konvente nuk cenojnë privilegjet fiskale të funksionarëve diplomatikë dhe konsullorë që rrjedhin nga rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare apo nga dispozita të marrëveshjeve të veçanta.

## **KAPITULLI VI DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

Neni 30

### **Hyrja në fuqi**

Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e pesëmbëdhjetë pas datës më të vonshme në të cilën qeveritë respektive kanë njoftuar me shkrim njëra-tjetrën se formalitetet e kërkuara nga kushtetuta në shtetet e tyre respektive janë përmbushur dhe dispozitat e saj do të kenë efekt për vitet dhe periudhat tatimore duke filluar më ose më pas datës së parë të janarit të vitit kalendarik që vjen pas atij në të cilin Konventa ka hyrë në fuqi.

Neni 31

### **Përfundimi**

Kjo Konventë do të mbetet në fuqi deri në denoncimin nga njëri Shtet Kontraktues. Secili Shtet Kontraktues mund të përfundojë Konventën, duke dhënë njoftimin me shkrim të përfundimit nëpërmjet kanaleve diplomatike, të paktën gjashtë muaj përpara përfundimit të çdo viti kalendarik që fillon pas përfundimit të një periudhe prej pesë vitesh nga data e hyrjes së saj në fuqi. Në rast të tillë, Konventa do të pushojë së pasuri efekt për vitet dhe periudhat tatimore që pasojnë mbarimin e vitit kalendarik në të cilin është dhënë njoftimi i përfundimit.

Të autorizuar në mënyrën e duhur, nënshkruarit kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Tiranë, më 22.7.2004, në dy kopje, në gjuhën shqipe, holandeze dhe angleze, dhe të tre tekstet janë autentikisht të barabartë. Në raste divergjencash interpretimi midis teksteve shqiptare dhe holandeze, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

## PROTOKOLL

Në momentin e nënshkrimit të Konventës për shmangien e tatimeve të dyfishta dhe për parandalimin e evazionit fiskal lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, të konkluduar sot ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërië së Holandës, nënshkruesit ranë dakord që dispozitat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e Konventës.

### I.

#### Shtesë nenit 2

Është e kuptueshme që kjo Konventë do të zbatohet mbi tatimin mbi kapitalin menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Konvente dhe kur të dy shtetet të kenë adoptuar një tatim të përgjithshëm mbi kapitalin.

### II

#### Shtesë nenit 3 paragrafi 1, nënparagrafi e

Në rast se një ent i cili trajtohet si një subjekt i veçantë për qëllime tatimore i nënshtrohet tatimit në një Shtet Kontraktues, por të ardhurat e këtij enti taten në Shtetin tjetër Kontraktues si një e ardhur të pjesëmarrësve (partnerëve) në këtë ent, autoritetet kompetente do të marrin masat që në njërin anë të mos ketë tatim të dyfishtë dhe në anën tjetër të parandalohet fakti që thjesht, për shkak të zbatimit të Konventës, të ardhura (të pjesshme) nuk i nënshtrohen tatimit. Nëse është e nevojshme, autoritetet kompetente mundet që të marrin masa për të devijuar nga legjislacioni i brendshëm, por në përputhje me përmbajtjen e Konventës.

### III

#### Shtesë neneve 3, 4, 8, 13 dhe 22

Është e kuptueshme që kur përcaktohet “vendi i drejtimit efektiv” siç përmendet në nënparagrafin “g” të paragrafit 1 të nenit 3 të paragrafit 3 të nenit 4, paragrafit 1 të nenit 8, paragrafit 3 të nenit 13 dhe në paragrafin 3 të nenit 22, rrethanat të cilat, ndër të tjera, duhen marrë në konsideratë janë vendi ku një kompani aktualisht është e drejtuar dhe kontrolluar, vendi ku merren vendimet e nivelit të lartë mbi politikat e rëndësishme thelbësore për drejtimin e kompanisë, vendi i cili luan rol kryesor në drejtimin e një kompanie nga pikëpamja ekonomike dhe funksionale dhe vendi ku mbahen librat më të rëndësishëm të kontabilitetit.

### IV

#### Shtesë nenit 4

1. Termi “rezident i një Shteti Kontraktues” përfshin gjithashtu një fond pensionesh, i cili njihet dhe kontrollohet sipas dispozitave statutorë të një Shteti Kontraktues dhe të ardhurat e të cilit zakonisht përjashtohen nga tatimet në atë shtet.

2. Një individ që jeton në bordin e një anijeje pa asnjë banesë reale në asnjërin prej Shteteve Kontraktuese do të konsiderohet se është një rezident i Shtetit Kontraktues në të cilin anija ka portin e regjistrimit.

### V

#### Shtesë nenit 5

2. Është e kuptueshme që përdorimi i ambienteve vetëm me qëllim shpërndarjen e produkteve apo mallrave që i përkasin një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues, sipas kuptimit të nenit 5 në vetvete nuk përbën një seli të përhershme të kësaj sipërmarrjeje në Shtetin tjetër Kontraktues. Megjithatë, nëse kjo shpërndarje kryhet e kombinuar me ndonjë aktivitet, të ndryshëm nga aktivitetet e përmendura në paragrafin 4 të nenit 5 të kësaj sipërmarrjeje në Shtetin tjetër Kontraktues, atëherë kjo sipërmarrje do të konsiderohet se ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty.

2. Për më tepër, është e kuptueshme që çdo kombinacion i aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët nga “a” deri në “e” të paragrafit 4 të nenit 5, i ushtruar prej një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues nuk do të konsiderohet se përbën një seli të përhershme të sipërmarrjes në këtë Shtet tjetër Kontraktues, me kusht që i gjithë aktiviteti të konsiderohet si një aktivitet me karakter ndihmës apo përgatitor.

## VI

Shtesë neneve 5, 6, 7, 13 dhe 23A

Është e kuptueshme që të drejtat e zbulimit dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore, do të konsiderohen si pasuri e paluajtshme e vendosur në Shtetin Kontraktues ku ndodhet tabani detar dhe nëntoka me të cilën lidhen këto të drejta, dhe se këto të drejta do të konsiderohen se i përkasin pronësisë së një selie të përhershme në këtë shtet. Për më tepër, është e kuptueshme që të drejtat e përmendura më sipër përfshijnë të drejtat për interesat apo përfitimet prej tyre, ndaj aseteve që prodhohen prej këtij zbulimi apo shfrytëzimi.

## VII

Shtesë neneve 5, 7, 10, 11, 12, 13, 15, 21, 22, 24

Është e kuptueshme që një vend fiks biznesi i një sipërmarrjeje nëpërmjet të cilit ushtrohet tërësisht apo pjesërisht biznesi nënkupton një vend fiks biznesi nëpërmjet të cilit një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues, tërësisht apo pjesërisht, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues.

## VIII

Shtesë nenit 7

Në lidhje me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 7, është e kuptueshme që kur një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues shet produkte ose mallra apo ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, fitimet e kësaj selie të përhershme do të përcaktohen vetëm mbi bazë të kësaj sasive të ardhurash të sipërmarrjes që i atribuohet aktivitetit aktual të selisë së përhershme në lidhje me këto shitje apo biznes. Veçanërisht, në rastet e kontratave të mbikëqyrjes, furnizimit, instalimit apo konstruksioneve industriale, godinave apo pajisjeve komerciale apo shkencore, apo të punëve publike, kur sipërmarrja ka një seli të përhershme, fitimet që i atribuohen kësaj selie të përhershme do të përcaktohen vetëm mbi bazë të asaj pjese të kontratës, e cila efektivisht kryhet nga selija e përhershme në Shtetin Kontraktues ku ndodhet selia e përhershme. Fitimet që i përkasin asaj pjese të kontratës e cila është kryer nga zyra qendrore e sipërmarrjes do të taten vetëm në Shtetin Kontraktues rezidente e të cilit është sipërmarrja.

## IX

Shtesë nenit 7

Pagesat e marra si një shpërblim për shërbimet teknike, përfshirë studimet apo kërkimet shkencore, gjeologjike apo të natyrës teknike, ose për shërbime konsulence apo të mbikëqyrjes do të konsiderohen si pagesa mbi të cilat aplikohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14.

## X

Shtesë nenit 8

Është e kuptueshme që, për qëllime të nenit 8, fitimet që rrjedhin nga aktiviteti në trafikun ndërkombëtar të anijeve dhe avionëve përfshijnë fitimet që rrjedhin nga qiradhënia e anijeve apo avionëve pa ekuipazh nëse operojnë në trafikun ndërkombëtar dhe nëse këto fitime nga qiraja janë burim rastësor të ardhurash për fitimet e përshkruara në paragrafin 1 të nenit 8.

## XI

Shtesë nenit 9

Përsa i përket aplikimit të nenit 9, është e kuptueshme që për marrëveshjet e përfunduara midis sipërmarrjeve të lidhura, të tilla si marrëveshjet për ndarjen e kostos ose marrëveshje për shërbimet e përgjithshme, për ose bazuar në alokimin e shpenzimeve ekzekutive, të përgjithshme administrative, teknike dhe komerciale dhe shpenzimeve të tjera të ngjashme, nuk është në vetvete një kusht, siç përmendet në paragrafin 1 të nenit 9 dhe do të trajtohet sipas parimeve të nenit 9 dhe mund të përshtatet për qëllime tatimore, në të njëjtën mënyrë sikurse çdo transaksion tjetër midis sipërmarrjeve të lidhura.

## XII

Shtesë nenit 10

Shteti Kontraktues, rezidente e të cilit është një kompani, pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2, nuk do të vendosë tatim mbi dividendët e paguar nga kjo kompani, nëse pronari përfitues i dividendëve është një fond pensionesh, siç përshkruhet në paragrafin IV të këtij protokollit.

### XIII

Shtesë neneve 10, 11 dhe 12

Kur tatimi i vendosur në burim është më i madh se shumica e tatimit që duhet vendosur në zbatim të dispozitave të neneve 10, 11 ose 12 aplikimi për rimbursimin e pjesës që kalon tatimin sipas këtyre neneve, do të bëhet nga autoriteti kompetent i shtetit që ka vjelur tatimin, brenda një periudhe prej tre vjetësh pas përfundimit të vitit kalendarik në të cilin është vjelur tatimi.

### XIV

Shtesë neneve 10 dhe 13

Është e kuptueshme që të ardhurat e marra në lidhje me likuidimin (e pjesëshëm) të një kompanie ose blerjen e pronësisë së aksioneve nga një kompani trajtohet si e ardhur nga aksionet dhe jo si fitim nga kapitali.

### XV

Shtesë nenit 13 paragrafi 4

Është e kuptueshme që autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok për secilin rast në veçanti, nëse pasuria e një kompanie, direkt apo indirekt, përbëhet kryesisht nga pasuri e paluajtshme apo jo.

### XVI

Shtesë nenit 10 paragrafi 8 dhe nenit 13 paragrafi 6

Përsa i përket zbatimit të paragrafit 8 të nenit 10 dhe paragrafit 6 të nenit 13, termi “një kompani e cila sipas ligjeve të një Shteti Kontraktues është rezidente e këtij Shteti” përfshin:

- a) një kompani e cila ka vendin e drejtimit efektiv në këtë Shtet Kontraktues; dhe
- b) një kompani vendi i drejtimit efektiv i së cilës është transferuar nga ky Shtet Kontraktues, me kusht që vendi i drejtimit efektiv të kësaj kompanie, përpara transferimit të vendit të drejtimit efektiv të sipërpërmendur, ishte vendosur për një periudhë të paktën prej pesë vjetësh në këtë Shtet Kontraktues. Në këtë rast, kjo kompani do të konsiderohet se është reziente e këtij Shteti Kontraktues vetëm për një periudhë prej dhjetë vjetësh pas transferimit të vendit të saj të drejtimit efektiv.

### XVII

Shtesë nenit 16

1. Është e kuptueshme që neni 16 zbatohet gjithashtu mbi shpërblimet e paguara një personi për llogari të funksioneve të tjera të kryera për këtë sipërmarrje, siç përmendet në nenin 16.

2. Është e kuptueshme që në rastin e Holandës një anëtar i një bordi drejtorësh apo organi të ngjashëm përfshin një “bestuurder or commissaris” (menaxhues mbikëqyrës) të një kompanie holandeze, nënkuptohen personat, të cilët janë emëruar si të tillë nga mbledhja e përgjithshme e aksionarëve ose nga ndonjë organ kompetent i kësaj kompanie dhe janë të ngarkuar nga ajo respektivisht, me drejtimin e përgjithshëm dhe supervizionin e kompanisë.

### XVIII

Shtesë nenit 25

Autoritetet kompetente të shteteve mundet gjithashtu të bien dakord në lidhje me ndonjë marrëveshje të arritur, si rezultat i procedurës së mirëkuptimit reciprok siç përmendet në nenin 25, që nëse kjo marrëveshje është në kundërshtim me legjislacionin e tyre kombëtar, shteti në të cilin ka një ngarkesë tatimore shtesë, si rezultat i marrëveshjes së sipërpërmendur, nuk do të vendosë rritje të tatimit, interesa dhe kosto në lidhje me këtë tatim shtesë, nëse shteti tjetër në të cilin ka një reduktim të tatimit përkatës si rezultat i Marrëveshjes, ndërpret pagesën e çdo interesi në lidhje me një reduktim të tillë tatimi.

### XIX

Shtesë nenit 26

Neni 26, për nëndarjet politike apo autoritetet lokale, nuk do të aplikohet mbi tatime të tjera nga ato që mbulon kjo Konventë.

### XX

Nënkuptohet se nëse Antilet Holandeze dhe/ose Aruba kanë adoptuar një sistem tatimor, i cili është në përputhje me parimet ndërkombëtare të pranuar (të ashtuquajturat standarde të OECD-

së) dhe nëse politika e zbatimit të ligjeve është gjithashtu në konformitet me parimet e sipërpërmendura, Shqipëria është e përgatitur të marrë në konsideratë diskutimin me këto vende të mundësisë së përfundimit të një konvente dypalëshe për shmangien e tatimeve të dyfishta dhe parandalimin e evazionit fiskal.

Nënshkruarit, të autorizuar në mënyrën e duhur, nënshkruan këtë protokoll.

Bërë në Tiranë, më 22.7.2004 në dy kopje në gjuhën shqipe, holandeze dhe angleze dhe të tre tekste janë autentikisht të barabarta. Në raste divergjencash interpretimi midis teksteve shqiptare dhe holandeze, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

## LIGJ

Nr. 9383, datë 4.5.2005

### **PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS PËR SHMANGIEN E TAKSIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL, LIDHUR ME TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4589, datë 1.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**

#### **MARRËVESHJE**

#### **NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS PËR SHMANGIEN E TAKSIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL, LIDHUR ME TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Kinës, duke dëshiruar të përfundojnë një marrëveshje për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe për parandalimin e evazionit fiskal, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1  
**Fushëveprimi i Marrëveshjes**

Kjo Marrëveshje do të zbatohet ndaj personave që janë rezidentë të njërit ose e të dy Shteteve Kontraktuese.

Neni 2  
**Tatimet që mbulon Marrëveshja**

1. Kjo Marrëveshje do të zbatohet për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të vendosura në emër të një Shteti Kontraktues ose nga autoritetet e tij lokale, pavarësisht nga mënyra e vjeljes së tyre.

2. Do të konsiderohen tatime mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të gjitha tatimet e vendosura mbi të ardhurat totale, mbi kapitalin në total ose mbi elemente të të ardhurave ose të kapitalit, përfshirë tatimet mbi fitimet nga tjetërsimi i pasurive të luajshme ose të paluajshme, si edhe tatimet mbi rivlerësimin e kapitalit.

3. Tatimet ekzistuese ndaj të cilave do të zbatohet Marrëveshja, janë në veçanti:

a) Në Shqipëri:

i) tatimet mbi të ardhurat (përfshirë tatimin mbi fitimin e shoqërive dhe tatimin mbi të ardhurat personale);

ii) tatimi mbi aktivitetet e biznesit të vogël;

iii) tatimi mbi pasurinë;

(në vijim do t'u referohemi si "Tatimet shqiptare").

b) Në Kinë:

i) tatimi mbi të ardhurat personale;

ii) tatimi mbi të ardhurat e sipërmarrjeve me investime të huaja dhe i sipërmarrjeve të huaja; (në vijim do t'u referohemi si "Tatimet kineze").

4. Marrëveshja do të zbatohet gjithashtu për tatime të njëllajta ose tepër të ngjashme, të cilat do të vendosen pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes, si shtojcë, ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do t'i bëjnë të ditur njëri-tjetrit çdo ndryshim të rëndësishëm që do të bëhet në ligjet e tyre përkatëse tatimore.

Neni 3  
**Përkufizime të përgjithshme**

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe:

a) Termi "Shqipëria" nënkupton Republikën e Shqipërisë dhe, kur përdoret në sensin gjeografik, nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si edhe çdo zonë përtej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, e cila, në bazë të ligjeve të saj dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, është një zonë brenda së cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejta lidhur me tabanin detar, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;

b) termi "Kina", nënkupton Republikën Popullore të Kinës; kur përdoret në sensin gjeografik, nënkupton territorin e Republikës Popullore të Kinës, përfshirë ujërat e saj territoriale, në të cilat aplikohet legjislacioni tatimor kinez, dhe çdo zonë përtej ujërave territoriale, brenda së cilës Republika Popullore e Kinës ka të drejta sovraane për zbulimin dhe shfrytëzimin e burimeve të tabanit detar dhe nëntokës së tij, dhe burimeve ujore në përputhje me të drejtën ndërkombëtare;

c) termat "një Shtet Kontraktues" dhe "Shteti tjetër Kontraktues" nënkuptojnë Shqipërinë ose Kinën, siç e kërkon përmbajtja;

d) termi "tatim" nënkupton tatimin shqiptar ose tatimin kinez, siç e kërkon përmbajtja;

e) termi "person" përfshin një individ, një shoqëri dhe çdo grup tjetër personash;

f) termi “shoqëri” nënkupton çdo trup korporativ ose çdo ent që trajtohet si trup korporativ (person juridik) për qëllime tatimore;

g) termat “sipërmarrje e një Shteti Kontraktues” dhe “sipërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues” nënkuptojnë respektivisht një sipërmarrje të ushtruar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe një sipërmarrje të ushtruar nga një resident i Shtetit tjetër Kontraktues;

h) termi “nënshtetas” nënkupton:

i) çdo individ që zotëron nënshtetësinë e një Shteti Kontraktues;

ii) çdo person juridik, ortakëri ose shoqatë që gëzojnë statusin si të tillë në përputhje me ligjet në fuqi në një Shtet Kontraktues;

i) termi “trafik ndërkombëtar” nënkupton çdo transport me anije ose me avion që kryhet nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues, përveç kur anija apo avioni operohet vetëm brendapërbrenda Shtetit tjetër Kontraktues;

j) termi “autoritet kompetent” nënkupton:

i) në rastin e Shqipërisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;

ii) në rastin e Kinës, Administratën Shtetërore të Tatimeve ose përfaqësuesin e autorizuar prej saj.

2. Përsa i përket zbatimit të kësaj Marrëveshjeje nga një Shtet Kontraktues, çdo term i papërcaktuar këtu, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe, do të ketë kuptimin që i është dhënë sipas legjislacionit të atij shteti lidhur me tatimet e të cilit zbatohet Marrëveshja. Çdo kuptim sipas legjislacionit tatimor të atij shteti ka përparësi ndaj kuptimit të dhënë atij termi sipas ligjeve të tjera të atij shteti.

#### Neni 4

#### **Rezidenca**

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termi “rezident i një Shteti Kontraktues” nënkupton çdo person që, sipas ligjeve të atij shteti, është subjekt i tatimeve atje për shkak të vendbanimit, rezidencës, vendit të drejtimit apo çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme, dhe gjithashtu përfshin atë shtet dhe çdo autoritet lokal atje. Por, sidoqoftë, ky term nuk përfshin personat që i nënshtrohen tatimit në atë shtet vetëm për të ardhura nga burime në atë shtet apo kapitali i vendosur aty.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një individ është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëherë statusi i tij do të përcaktohet si vijon:

a) Ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit në të cilin ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij; në qoftëse ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në të dy shtetet, ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit me të cilin interesat e tij personale dhe ekonomike janë të lidhura më ngushtë (qendra e interesave jetike).

b) Në qoftë se shteti në të cilin ai ka qendrën e interesave jetike nuk mund të përcaktohet ose në qoftë se ai nuk ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në asnjërin shtet, ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit në të cilin ai qëndron zakonisht.

c) Në qoftë se ai qëndron rregullisht në të dy shtetet ose në asnjërin prej tyre, ai do të konsiderohet rezident i shtetit, nënshtetas i të cilit ai është.

d) Në qoftë se ai është nënshtetas i të dy shteteve ose i asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do ta zgjidhin këtë çështje me mirëkuptim reciprok.

3. Kur, për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një person jo individ është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëherë Shtetet Kontraktuese do ta zgjidhin çështjen me mirëkuptim reciprok.

#### Neni 5

#### **Seli e përhershme**

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termi “seli e përhershme” nënkupton një vend fiks biznesi nëpërmjet të cilit një sipërmarrja e një Shteti Kontraktues, tërësisht ose pjesërisht, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues.

2. Termi “seli e përhershme” përfshin në veçanti:

a) një vend drejtimi;

b) një degë;

c) një zyrë;

d) një fabrikë;

e) një punishte;

f) një minierë, një pus naftë ose gazi, një gurore ose çdo vend tjetër për shfrytëzimin e burimeve natyrore.

3. Termi “seli e përhershme” gjithashtu përfshin:

a) një shesh ndërtimi, një konstruksion apo projekt instalimi apo aktivitete mbikëqyrjeje të lidhura me to, por vetëm kur ky shesh, projekt apo aktivitete vazhdojnë për një periudhë prej më shumë se nëntë muaj brenda çdo periudhe dymbëdhjetëmuajore;

b) furnizimi i shërbimeve, përfshirë shërbimet e konsulencës, nga një sipërmarrje nëpërmjet të punësuarve apo personeli tjetër të përdorur nga sipërmarrja për këtë qëllim, por vetëm kur aktivitete të kësaj natyre vazhdojnë brenda vendit për një periudhë ose periudha që në total i kalojnë nëntë muaj në çdo periudhë dymbëdhjetëmuajore.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mëparshme të këtij neni, termi “seli e përhershme” nuk do të përfshijë:

a) përdorimin e pajisjeve apo objekteve vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarje të mallrave që i përkasin sipërmarrjes;

b) mbajtjen e një gjendjeje mallrash që i përkasin sipërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarje;

c) mbajtjen e një gjendjeje mallrash që i përkasin sipërmarrjes vetëm për qëllime përpunimi nga një sipërmarrje tjetër;

d) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim blerjen e mallrave ose për mbledhje informacioni, për sipërmarrjen;

e) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim të ushtrimit, për sipërmarrjen, të çdo aktiviteti tjetër me karakter përgatitor ose ndihmës;

f) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët (a) deri (e), me kusht që aktiviteti në përgjithësi i vendit fiks të biznesit që rezulton nga një kombinim i tillë është i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person-i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur ndaj të cilit zbatohet paragrafi 6-vepron në një Shtet Kontraktues në emër të një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, ajo sipërmarrje do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në Shtetin Kontraktues të përmendur në fillim, lidhur me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për sipërmarrjen, nëse ai person ka dhe zakonisht ushtron në atë shtet autoritetin për të përfunduar kontrata në emër të sipërmarrjes, përveç kur aktivitetet e këtij personi kufizohen në ato të përmendura në paragrafin 4, të cilat edhe kur ushtrohen nëpërmjet një vendi fiks biznesi, nuk do ta bënin këtë vend fiks biznesi të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi.

6. Një sipërmarrje nuk do të konsiderohet se ka një seli të përhershme të një Shtet Kontraktues vetëm për faktin se ajo ushtron biznes në këtë shtet nëpërmjet një ndërmjetësi, komisioneri të përgjithshëm apo çdolloj agjenti tjetër me një status të pavarur, me kusht që të tillë persona veprojnë brenda kuadrit të zakonshëm të aktivitetit të tyre. Megjithatë, kur aktivitetet e një agjenti të tillë ushtrohen totalisht ose thuhet totalisht në emër të asaj sipërmarrjeje, ai do të konsiderohet një agjent me status të pavarur në kuptimin e këtij paragrafi.

7. Fakti që një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues kontrollon ose kontrollohet nga një shoqëri që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues, ose që ushtron aktivitet në atë shtet tjetër (nëpërmjet një selie të përhershme ose në forma të tjera) nuk përbën në vetvete arsye të mjaftueshme për të konsideruar një të shoqëri seli të përhershme të tjetrës.

## Neni 6

### **Të ardhurat nga pasuria e paluajtshme**

1. Të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga pasuria e paluajtshme (përfshirë të ardhurat nga bujqësia dhe pyjet) të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatonen në këtë shtet tjetër.

2. Termi “pasuri e paluajtshme” do të ketë kuptimin që ka sipas ligjit të Shtetit Kontraktues ku është vendosur prona në fjalë. Në çdo rast, ky term do të përfshijë pasuritë aksesore të pasurisë së paluajtshme, inventarin e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi e në pyje, të drejtat ndaj të cilave zbatohen dispozitat e legjisllacionit të përgjithshëm lidhur me pronën mbi tokën, uzufukti i pasurive të paluajtshme dhe të drejtat ndaj pagesave fikse ose variabël për shfrytëzimin ose të drejtën për të shfrytëzuar vendburimet minerare dhe burime e pasuri të tjera natyrore. Anijet dhe avionët nuk konsiderohen pasuri të paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen ndaj të ardhurave të realizuara nga përdorimi direkt, dhënia me qira ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurive të paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 do të zbatohen gjithashtu ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e një sipërmarrjeje dhe ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e përdorur për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura.

## Neni 7

### **Fitimet biznesore**

1. Fitimet e një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues do të tatonen vetëm në atë shtet, përveç kur sipërmarrja ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty. Në qoftë se sipërmarrja ushtron aktivitetin në mënyrën e sipërpërmendur, fitimet e sipërmarrjes mund të tatonen në Shtetin tjetër, por vetëm ajo pjesë e tyre që i atribuohet asaj selie të përhershme.

2. Pa cenuar dispozitat e paragrafit 3, kur një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, atëherë në secilin Shtet Kontraktues selisë së përhershme do t'i atribuohen fitimet që ajo do të realizonte nëse ajo do të ishte një sipërmarrje e veçantë dhe e pavarur që do të vepronte në të njëjtin aktivitet ose në aktivitete të ngjashme nën kushte të njëjta ose të ngjashme dhe tërësisht e pavarur nga sipërmarrja, seli e përhershme e së cilës ajo është.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme, do të lejohet zbritja e shpenzimeve që janë kryer për qëllimet e aktivitetit selisë së përhershme, përfshirë shpenzimet e përgjithshme administrative dhe ekzekutive si në shtetin ku ndodhet selia e përhershme, ashtu edhe gjetkë.

4. Përderisa në një Shtet Kontraktues përcaktimi i fitimeve që i atribuohen një selie të përhershme bëhet në bazë të ndarjes së fitimeve totale të sipërmarrjes midis pjesëve të veçanta të saj, dispozitat e paragrafit 2 nuk e pengojnë atë Shtet Kontraktues të përcaktojë fitimet e tatueshme në bazë të kësaj metode; megjithatë, metoda e ndarjes e përdorur duhet të jetë e tillë që rezultati të jetë në përputhje me parimet që përmban ky nen.

5. Asnjë fitim nuk do t'i atribuohet një selie të përhershme vetëm për faktin se ajo blen mallra për sipërmarrjen.

6. Për qëllimet e paragrafëve të mësipërm, fitimet që do t'i atribuohen selisë së përhershme do të përcaktohen me të njëjtën metodë çdo vit, përderisa të mos ketë arsye të forta dhe të mjaftueshme për të proceduar ndryshe.

7. Kur fitimet përmbajnë elemente të të ardhurave që trajtohen veças në nene të tjera të kësaj Marrëveshjeje, atëherë dispozitat e atyre neneve nuk do të ndikohen nga dispozitat e këtij neni.

Neni 8  
**Transporti ndërkombëtar**

1. Fitimet e një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues nga veprimtaria e anijeve ose avionëve në trafikun ndërkombëtar do të taten vetëm në atë Shtet Kontraktues.

2. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen gjithashtu ndaj fitimeve e nga pjesëmarrja në një ortakëri, një biznes të përbashkët apo në një agjenci ndërkombëtare transporti.

Neni 9  
**Sipërmarrje të lidhura**

1. Kur:

a) një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin ose kapitalin e një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin apo kapitalin e një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues dhe të një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues,

dhe në secilin rast, kushtet që janë pranuar ose që janë vendosur midis dy sipërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare apo financiare ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin midis sipërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim që duhej të realizohej nga njëra sipërmarrje, por, për shkak të këtyre kushteve nuk është realizuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj sipërmarrjeje dhe të taten normalisht.

2. Kur një Shtet Kontraktues përfshin në fitimet e një sipërmarrjeje të atij shteti dhe i taton normalisht fitime mbi të cilat një sipërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues është ngarkuar me tatim në atë shtet tjetër dhe fitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitime që do të ishin realizuar nga sipërmarrja e shtetit të përmendur në fillim nëse kushtet e vendosura midis dy sipërmarrjeve do të ishin ato që do të vendoseshin midis sipërmarrjeve të pavarura, atëherë ai shtet tjetër do të bëjë rregullimin e duhur në shumën e tatimit të ngarkuar në atë shtet mbi ato fitime. Në përcaktimin e rregullimeve të tilla, do të respektohen edhe dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese në rast nevojë do të konsultohen me njëri-tjetrin.

Neni 10  
**Dividendët**

1. Dividendët e paguar nga një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të taten në këtë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto dividendë mund të taten gjithashtu në Shtetin Kontraktues, rezidente e të cilit është shoqëria paguese e dividendëve dhe në përputhje me ligjet e atij shteti, por nëse marrësi është pronari përfitues i dividendëve, tatimi i ngarkuar nuk do të kalojë 10 për qind të shumës bruto të dividendëve. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok mënyrën e zbatimit të këtyre kufizimeve.

Ky paragraf nuk do të ketë efekt mbi tatimin e shoqërisë lidhur me fitimet prej të cilave janë paguar dividendët.

3. Termi “dividendë” në përdorimin në këtë nen nënkupton të ardhurat nga aksionet e çdo lloji, apo të drejta të tjera që nuk janë kërkesa (tituj) borxhi, pjesëmarrjen në fitime, si edhe të ardhura nga të drejta të tjera të shoqërisë që i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor, si të ardhurat nga aksionet nga ligjet e shtetit, rezidente e të cilit është shoqëria që bën shpërndarjen e dividendëve.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i dividendëve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues, rezidente e të cilit është shoqëria paguese e dividendëve, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose ushtron në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe

zotërimi lidhur me të cilin janë paguar dividendët është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, si të paraqitet rasti.

5. Kur një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues realizon fitime ose të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, ky shtet tjetër mund të mos zbatojë tatim mbi dividendët e paguar nga shoqëria, përveç kur këto dividendë i paguhen një rezidenti të shtetit tjetër ose kur zotërimi lidhur me të cilin janë paguar dividendët është efektivisht i lidhur me një seli të përhershme ose bazë fikse të vendosur në këtë shtet tjetër; gjithashtu subjekt i tatimit mbi fitimet e pashpërndara të shoqërisë nuk janë as fitimet e pashpërndara të shoqërisë, edhe sikur dividendët e paguar ose fitimet e pashpërndara konsistojnë tërësisht ose pjesërisht si fitime apo të ardhura të realizuara në këtë shtet tjetër.

## Neni 11 Interesat

1. Interesat që realizohen (lindin) në një Shtet Kontraktues dhe i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të taten në këtë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto interesa mund të taten edhe në Shtetin Kontraktues ku ato krijohen dhe në përputhje me ligjet e atij shteti, por, nëse marrësi është pronari përfitues i interesave, tatimi i zbatuar nuk duhet të kalojë 10 për qind të shumës bruto të interesit. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të zgjidhin me mirëkuptim reciprok mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2, interesat e krijuara në një Shtet Kontraktues dhe të realizuara nga qeveria e Shtetit tjetër Kontraktues, një autoritet lokal dhe nga banka qendrore atje apo nga çdo institucion financiar tërësisht i zotëruar nga qeveria e atij shteti tjetër, do të përjashtohen nga tatimi në shtetin e përmendur në fillim.

4. Termi “interesa”, në kuptimin e përdorur në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga kërkesat (titujt) e borxhit të çdo lloji, të siguruar ose jo me hipotekim, dhe në veçanti, të ardhurat nga bonot e thesarit dhe obligacionet e çdo lloji, përfshirë edhe fitimet apo shpërblimet që rrjedhin nga këto bono apo obligacione. Gjjobat e ngarkuara për pagesa të vonuara nuk do të konsiderohen si interesa për qëllime të këtij neni.

5. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen në qoftë se pronari përfitues i interesave, duke qenë një rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në shtetin tjetër Kontraktues ku krijohen (lindin) interesat, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose ushtron në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe kërkesa e huasë lidhur me të cilën paguhet interesi është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, si të paraqitet rasti.

6. Interesat do të konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues kur pagesi është vetë ai shtet, një autoritet lokal ose një rezident i atij shteti. Megjithatë, kur personi që paguan interesat, qoftë ose jo rezident i njërit Shtet Kontraktues, ka në një Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose një bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur huaja për të cilën paguhet interesi dhe këto interesa krijohen nga kjo seli e përhershme apo bazë fikse, atëherë këto interesa do të konsiderohen se janë krijuar në shtetin ku është vendosur selia e përhershme ose baza fikse.

7. Kur për shkak të lidhjeve të veçanta midis pagesit dhe pronarit përfitues të interesave, ose midis të dwe dhe personave të tretë, shuma e interesave, bazuar në kërkesën e borxhit për të cilën ato paguhen, e kalon shumën mbi të cilën duhej të ishte rënë dakord midis pagesit dhe pronarit përfitues në mungesë të lidhjeve të tilla të veçanta, dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmendur në fund. Në këtë rast, pjesa që kalon pagesën normale do të mbetet e tatueshme në përputhje me ligjet e secilit Shtet Kontraktues, duke pasur parasysh edhe dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 12 Honoraret

1. Të ardhurat nga e drejta e përdorimit të pasurisë intelektuale (honoraret), që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të taten në këtë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto honorare mund të taten edhe në Shtetin Kontraktues ku ato krijohen dhe në përputhje me ligjet e atij shteti, por, nëse marrësi është pronari përfitues i honorareve, tatimi i zbatuar nuk duhet të kalojë 10 për qind të shumës bruto të honorareve. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të zgjidhin me mirëkuptim reciprok mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Termi “honorare”, nën dispozitat e këtij neni, nënkupton pagesat e çdo lloji të marra si shpërblim për përdorimin ose të drejtën e përdorimit të së drejtës së autorit për punimet letrare, artistike ose shkencore, përfshirë filmat kinematografikë, çdo patentë, markë tregtare, skicë ose model, plan, proces ose formulë sekrete, *know-how*, ose për përdorimin, ose të drejtën e përdorimit, të pajisjeve industriale, komerciale apo shkencore, ose të informacioneve lidhur me eksperiencën industriale, tregtare apo shkencore.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i honorareve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues ku krijohen honoraret, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose ushtron në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe e drejta ose prona lidhur me të cilën paguhen honoraret është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këto raste do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose të nenit 14, si të paraqitet rasti.

5. Honoraret do të konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues kur pagues është vetë ai shtet, një autoritet lokal ose një rezident i atij shteti. Megjithatë, kur personi që paguan këto honorare qoftë ose jo rezident i një Shteti Kontraktues, ka në njërin Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose një bazë fikse në lidhje me të cilin ka lindur e drejta e pagimit të këtyre honorare, dhe këto honorare kanë lindur nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë këto honorare konsiderohen se kanë lindur në shtetin ku është vendosur selia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur për shkak të lidhjeve të veçanta midis paguesit dhe pronarit përfitues ose midis të dyve dhe personave të tretë, shuma e honorareve, duke pasur parasysh përdorimin, të drejtën apo informacionin për të cilin ato janë paguar, e kalon shumën për të cilën do të ishte rënë dakord midis paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla të veçanta, atëherë dispozitat e këtij neni do të zbatohen mbi shumën e përmendur në fund. Në raste të tilla, shuma e shpërblimit që kalon shpërblimin normal mbetet e tatuashme sipas ligjeve përkatëse të secilit Shtet Kontraktues, duke pasur parasysh dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 13 Fitimet nga kapitali

1. Fitimet e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme që i referohen nenit 6 dhe të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues mund të taten në këtë shtet.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme që bëjnë pjesë në pasuritë biznesore të një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose i pasurive të luajtshme që i përkasin një baze fikse që një rezident i një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues me qëllim kryerjen e shërbimeve personale, përfshirë edhe fitimet nga tjetërsimi i vetë selisë së përhershme (vetëm ose bashkë me sipërmarrjen) ose i bazës fikse, mund të taten në këtë shtet tjetër.

3. Fitimet e realizuara nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i anijeve ose avionëve që veprojnë në trafikun ndërkombëtar, ose i pasurive të luajtshme që i përkasin veprimtarisë së këtyre anijeve ose avionëve do të taten vetëm në atë Shtet Kontraktues.

4. Fitimet nga tjetërsimi i aksioneve të kapitalit aksionar të një shoqërie, ose i interesave (pjesëmarrjes) në një ortakëri, ose trust, pronësia e të cilave konsiston direkt ose indirekt kryesisht në pasuri të paluajtshme të vendosura në një Shtet Kontraktues mund të taten në atë shtet.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo pasurie që nuk mbulohet nga paragrafët e mëparshëm të këtij neni, do të taten vetëm në Shtetin Kontraktues rezident i të cilit është tjetërsuesi.

#### Neni 14

### **Shërbimet personale të pavarura**

1. Të ardhurat e realizuara nga një individ që është rezident i një Shteti Kontraktues lidhur me shërbimet profesionale ose shërbime të tjera të ngjashme të një karakteri të pavarur do të taten vetëm në atë shtet përveç në rrethanat që vijojnë, kur këto të ardhura mund të taten gjithashtu në Shtetin tjetër Kontraktues:

a) nëse ai ka një bazë fikse në dispozicion të tij në Shtetin tjetër Kontraktues, që rregullisht i shërben atij për të kryer aktivitetet e tij; në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i atribuohet kësaj baze fikse mund të taten në këtë shtet tjetër ose

b) nëse qëndrimi i tij në Shtetin tjetër Kontraktues është për një periudhë ose periudha që në total arrijnë ose i kalojnë 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore që fillon ose përfundon në vitin kalendarik përkatës, në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave të realizuara nga aktivitetet e tij të kryera në këtë shtet tjetër mund të taten në këtë shtet tjetër.

2. Termi “shërbime profesionale” përfshin në veçanti aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore apo të mësimdhënies, si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve, dentistëve dhe kontabilistëve.

#### Neni 15

### **Të ardhurat nga punësimi**

1. Pa cenuar dispozitat e neneve 16, 18, 19, 20 dhe 21, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme që përfitohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga punësimi i tij do të taten vetëm në këtë shtet, përveç kur puna është ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse puna ushtrohet në këtë mënyrë (pra në këtë Shtet tjetër Kontraktues), atëherë këto të ardhura mund të taten në këtë shtet tjetër.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues lidhur me punën e ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues do të taten vetëm në shtetin e përmendur në fillim në qoftë se plotësohen të gjitha kushtet që vijojnë:

a) përfituesi (marrësi) është prezent në shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i kalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore, që fillon ose përfundon në vitin kalendarik përkatës;

b) shpërblimi paguhet nga ose në emër të një punëdhënësi që nuk është rezident i shtetit tjetër dhe

c) shpërblimi nuk ka lindur nga një seli e përhershme ose bazë fikse që punëdhënësi ka në shtetin tjetër.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, shpërblimet e përfituara lidhur me punën e ushtruar në bordin e një anijeje ose avioni që operohet në trafikun ndërkombëtar nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues mund të taten në atë Shtet Kontraktues.

#### Neni 16

### **Shpërblimet e drejtorëve**

Shpërblimet e drejtorëve dhe pagesa të tjera të ngjashme të realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues në pozitën e tij si anëtar i këshillit të drejtorëve ose çdo organi të ngjashëm të një shoqërie që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues mund të taten në këtë shtet tjetër.

Neni 17  
**Artistët dhe sportistët**

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 14 dhe 15, të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues si një artist, si aktor teatri, kinematografie, radio ose televizioni, si muzikant apo sportist, nga aktivitetet e tij personale si të tilla, të ushtruara në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të taten në këtë shtet tjetër.

2. Kur të ardhurat lidhur me aktivitetet personale të ushtruara nga një artist ose sportist, në pozitën e tij si të tillë nuk realizohen direkt nga artisti apo sportisti por nga një person tjetër, këto të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 14 dhe 15, mund të taten në Shtetin Kontraktues në të cilin janë ushtruar aktivitetet e artistit apo sportistit.

3. Pavarësisht nga dispozitat e mëparshme të këtij neni, të ardhurat e realizuara nga artistë apo sportistë, që janë rezidentë të një Shteti Kontraktues, nga aktivitetet e ushtruara në Shtetin tjetër Kontraktues, në bazë të një plani për shkëmbime kulturore midis qeverive të dy Shteteve Kontraktuese, do të përjashtohen nga tatimi në atë shtet tjetër.

Neni 18  
**Pensionet**

1. Pa cenuar dispozitat e paragrafit 2 të nenit 19, pensionet dhe shpërblime të tjera të ngjashme paguar një rezidenti të një Shteti Kontraktues lidhur me punësimin e tij në të kaluarën do të taten vetëm në atë shtet.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, pensionet dhe pagesa të tjera të ngjashme, të paguara nga qeveria e një Shteti Kontraktues apo nga një autoritet lokal atje në bazë të një skeme shtetërore të sistemit të sigurimeve shoqërore të atij shteti, do të taten vetëm në atë shtet.

Neni 19  
**Shërbimet qeveritare**

1. a) Rrogat dhe pagat, si edhe shpërblime të tjera të ngjashme, të ndryshme nga pensionet, të paguara nga një Shtet Kontraktues ose nga një autoritet lokal atje një individ lidhur me shërbimet e kryera atij shteti ose autoriteti, do të taten vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto shpërblime do të taten vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues nëse shërbimet janë kryer në atë shtet dhe individ është rezident i atij shteti, i cili (individ):

i) është nënshtetas i atij shteti ose

ii) nuk është bërë rezident i atij shteti vetëm për qëllim të kryerjes së shërbimeve.

2. a) Çdo pension i paguar nga ose prej fondeve të krijuara nga një Shtet Kontraktues, ose një autoritet lokal atje një individ lidhur me shërbimet e kryera atij shteti, nëndarje politike ose autoriteti lokal do të taten vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto pensione do të taten vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues nëse individ është rezident dhe nënshtetas i këtij shteti tjetër.

3. Dispozitat e neneve 15, 16, 17 dhe 18 do të zbatohen mbi pagat, rrogat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, dhe mbi pensionet, lidhur me shërbimet e kryera në lidhje me një aktivitet biznesi të ushtruar nga një Shtet Kontraktues ose një autoritet lokal atje.

Neni 20  
**Mësuesit dhe kërkuesit shkencorë**

1. Shpërblimet që një individ që është ose ishte menjëherë para vajtjes në një Shtet Kontraktues, rezident i Shtetit tjetër Kontraktues dhe që është prezent në shtetin e përmendur në

fillim për qëllimin kryesor të mësimdhënies, dhënies së leksioneve apo kryerjes së një kërkimi shkencor në një universitet, kolegji, shkollë apo institucion arsimor, apo institucion kërkimesh shkencore të njohura nga qeveria e shtetit të përmendur në fillim, realizon nga kjo mësimdhënie, leksione apo kërkime shkencore, nuk do të tatonen në shtetin e përmendur në fillim, për një periudhë prej dy vjetësh nga data e mbërritjes së parë në shtetin e përmendur në fillim.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni nuk do të aplikohen ndaj të ardhurave nga kërkimet shkencore nëse të tilla kërkime nuk janë ndërmarrë për interesin publik, por kryesisht për përfitimet private të një personi apo grupi personash.

#### Neni 21

### **Studentët dhe specialistët**

1. Kur një student apo specialist që është ose ishte menjëherë, para vajtjes në një Shtet Kontraktues, rezident i Shtetit tjetër Kontraktues dhe që është prezent në Shtetin e përmendur në fillim vetëm për qëllim të arsimimit ose specializimit të tij, për çdo pagesë të marrë për qëllim të jetesës së tij, arsimimit apo specializimit, nuk do të tatonet në atë shtet, me kusht që këto pagesa të kryhen nga burime jashtë atij shteti.

2. Përsa i përket dhurimeve, bursave dhe shpërblimeve nga punësimi që nuk mbulohej nga paragrafi 1, që një student ose specialist i përshkruar në paragrafin 1 merr si shtesë, këto të ardhura do të gëzojnë, gjatë periudhës së arsimimit ose trajnimit, të njëjtat përjashtime, lehtësi apo reduktime tatimore si rezidentët e shtetit ku ata janë prezent.

#### Neni 22

### **Të ardhura të tjera**

1. Lloje të të ardhurave të një rezidenti të një Shteti Kontraktues, kudo që të krijohen, që nuk lidhen me nenet e mëparshme të kësaj Marrëveshjeje do të tatonen në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen ndaj të ardhurave, të ndryshme nga të ardhurat nga pasuria e paluajtshme të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 6, nëse përfituesi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryhen në atë shtet tjetër shërbime të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe e drejta ose pasuria lidhur me të cilën paguhen shpërblimi është efektive dhe lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose 14, si të paraqitet rasti.

#### Neni 23

### **Kapitali**

1. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të paluajtshme të referuara në nenin 6, të zotëruara nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatonen në këtë shtet tjetër.

2. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të luajtshme, që bëjnë pjesë në pasurinë biznesore të një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose nga pasuri të luajtshme që i përkasin një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura, mund të tatonen në këtë shtet tjetër.

3. Kapitali i përfaqësuar nga anije dhe avionë të operuara në trafikun ndërkombëtar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe nga pasuritë e luajtshme që i përkasin aktivitetit të këtyre anijeve dhe avionëve do të tatonet vetëm në këtë Shtet Kontraktues.

4. Të gjitha elementet e tjera të kapitalit të një rezidenti të një Shteti Kontraktues do të tatonen vetëm në atë shtet.

Neni 24  
**Eliminimi i tatimit të dyfishtë**

Tatimi i dyfishtë do të eliminohet si vijon:

1. Në Shqipëri:

a) Kur një rezident i Shqipërisë realizon të ardhura ose zotëron kapitale të cilat, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mund të taten në Kinë, Shqipëria do të lejojë:

i) një reduktim nga tatimi shqiptar mbi të ardhurat e atij rezidenti, të një shume të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në Kinë dhe

ii) një reduktim nga tatimi shqiptar mbi kapitalin e atij rezidenti, të një shume të barabartë me tatimin mbi kapitalin të paguar në Kinë.

Megjithatë, në secilin rast, ky reduktim nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit shqiptar mbi të ardhurat ose kapitalin të llogaritur para dhënies së reduktimit që i atribuohet, sipas rastit, të ardhurave ose kapitalit që mund të taten në Kinë.

b) Kur në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes, të ardhurat e realizuara ose kapitali i zotëruar nga një rezident i Shqipërisë përjashtohen nga tatimi në Shqipëri, megjithatë, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi të ardhurat ose kapitalin e mbetur të këtij rezidenti, Shqipëria merr parasysh të ardhurat ose kapitalin e përjashtuar.

2. Në Kinë:

Kur një rezident i Kinës realizon të ardhura ose zotëron kapitale në Shqipëri, shuma e tatimit mbi këto të ardhura apo këto kapitale të pagueshme në Shqipëri, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, mund të kreditohet përkundrejt tatimit kinëz të vendosur mbi këtë rezident. Megjithatë, shuma e kreditimit nuk do të kalojë shumën e tatimit kinëz mbi këto të ardhura apo këto kapitale të llogaritura në përputhje me ligjet dhe rregullat tatimore të Kinës.

Neni 25  
**Mosdiskriminimi**

1. Nënshetësit e një Shteti Kontraktues nuk do të jenë në Shtetin tjetër Kontraktues subjekt i ndonjë tatimi ose kërkese të lidhur me të, që të jetë i ndryshëm ose më i rëndë sesa tatimi ose kërkesat e lidhura me të, të cilave i nënshtrohen nënshetësit e këtij shteti tjetër në rrethana të njëjta, në veçanti lidhur me rezidencën. Kjo dispozitë, pavarësisht nga dispozitat e nenit 1, do të zbatohet gjithashtu ndaj personave që nuk janë rezidentë të njërit apo asnjërit prej Shteteve Kontraktuese.

2. Tatimi i një selie të përhershme, që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues, nuk do të jetë më pak i favorshëm në këtë shtet tjetër sesa tatimi i ngarkuar ndaj sipërmarrjeve të këtij shteti tjetër që ushtrojnë aktivitete të njëjta. Kjo dispozitë nuk do të merret si detyrim i njërit Shtet Kontraktues për t'i garantuar rezidentëve të Shtetit tjetër Kontraktues lehtësime personale dhe reduktime tatimore që i garanton rezidentëve të shtetit të vet për gjendjen civile dhe përgjegjësitë familjare që ata kanë.

3. Përjashtuar raste, kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9, paragrafit 7 të nenit 11 ose paragrafit 6 të nenit 12, interesat, honoraret dhe shpërblime të tjera të paguara nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj sipërmarrjeje, do të jenë të reduktueshme nën të njëjtat kushte njëllor sikur ato t'i paguheshin një rezidenti të shtetit të përmendur në fillim. Në mënyrë të ngjashme, çdo borxh i një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të kapitalit të tatueshëm të kësaj sipërmarrjeje, do të jetë i reduktueshëm nën të njëjtat kushte njëllor sikur sipërmarrja të kishte kontraktuar me një rezident të shtetit të përmendur në fillim.

4. Sipërmarrjet e një Shteti Kontraktues, kapitali i të cilave është totalisht ose pjesërisht i zotëruar apo kontrolluar, direkt ose indirekt nga një ose më shumë rezidentë të Shtetit tjetër Kontraktues, nuk do të jenë në shtetin e përmendur në fillim subjekt i ndonjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të, që të jetë më i rëndë sesa tatimi ose kërkesat e lidhura me të, të cilave i nënshtrohen sipërmarrje të tjera të ngjashme të shtetit të përmendur në fillim.

#### Neni 26

### **Procedura e mirëkuptimit reciprok**

1. Kur një person mendon se veprimet e njërit apo e të dy Shteteve Kontraktuese e rëndojnë apo do ta rëndojnë atë me tatime që nuk janë në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nga mënyrat e ankimit të parashikuara në legjislacionin e brendshëm të këtyre shteteve, ai mund t'ia paraqesë rastin e tij autoriteteve kompetente të Shtetit Kontraktues, rezident i të cilit ai është, ose nëse rasti lidhet me paragrafin 1 të nenit 25, ai mund t'ia paraqesë atë Shtetit Kontraktues nënshtetas i të cilit ai është. Çështja duhet të paraqitet brenda tre vjetëve nga njoftimi i parë lidhur me tatimin që nuk është në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes.

2. Autoriteti kompetent, nëse kërkesa i duket e justifikuar dhe ai vetë nuk e ka të mundur arritjen e një zgjidhjeje të kënaqshme, do të përpiqet ta zgjidhë çështjen me mirëkuptim reciprok me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, me synim shmangien e tatimit që nuk është në përputhje me Marrëveshjen. Çdo marrëveshje e arritur do të zbatohet pavarësisht nga kufijtë kohorë që mund të parashikojë legjislacioni i brendshëm i Shteteve Kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të përpiqen që me mirëkuptim reciprok të zgjidhin çdo vështirësi apo dyshim që lind nga interpretimi apo zbatimi i Marrëveshjes. Ato gjithashtu mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet kur një gjë e tillë nuk parashikohet nga Marrëveshja.

4. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të komunikojnë me njëri-tjetrin direkt për arritjen e mirëkuptimit në kuptimin e paragrafëve të mësipërm.

#### Neni 27

### **Shkëmbimi i informacionit**

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të shkëmbejnë informacionet e nevojshme për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje ose të ligjeve të brendshme të Shteteve Kontraktuese lidhur me tatimet që mbulon Marrëveshja, përderisa ato tatime nuk janë në kundërshtim me Marrëveshjen, në veçanti për parandalimin e evazionit për këto tatime. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga neni 1. Çdo informacion i marrë nga një Shtet Kontraktues do të trajtohet si sekret, në të njëjtën mënyrë si informacioni i marrë nën legjislacionin e brendshëm të atij shteti dhe do t'i serviret vetëm personave apo autoriteteve (përfshirë gjykatat dhe organet administrative) të përfshira në llogaritjen apo mbledhjen e tatimeve, në zbatimin e masave shtrënguese ose ndjekjet lidhur me shkeljet tatimore, apo lidhur me ankesat ndaj tatimeve që mbulon Marrëveshja. Këto persona apo autoritete do ta përdorin informacionin vetëm për të tilla qëllime. Ato mund ta servirin informacionin në procedurat apo vendimet gjyqësore.

2. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 1 nuk do të interpretohen në kuptimin që i imponojnë njërit prej Shteteve Kontraktuese detyrimin:

a) të zbatojë masa administrative në ndryshim me ligjet dhe praktikën administrative të atij Shteti apo të Shtetit tjetër Kontraktues;

b) të japë informacione që ndalohen sipas ligjeve dhe praktikës normale administrative të atij apo të Shtetit tjetër Kontraktues;

c) të japë informacione që mund të nxirrin një sekret tregtar, biznesor, industrial ose profesional apo proces tregtar, ose informacione, komunikimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me politikën publike (rendin publik).

Neni 28  
**Funksionarët diplomatikë dhe konsullorë**

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk cenojnë privilegjet fiskale të funksionarëve diplomatë dhe konsullorë që rrjedhin nga rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare apo nga dispozita të marrëveshjeve të veçanta.

Neni 29  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e tridhjetë pas datës së shkëmbimit të notave diplomatike që shprehin përmbushjen e procedurave të brendshme të nevojshme për secilin vend për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Kjo Marrëveshje do të ketë efekt në lidhje me të ardhurat e realizuara ose kapitalin e zotëruar gjatë viteve tatimore, që fillojnë më ose pas datës së parë të janarit pas vitit në të cilin Marrëveshja hyn në fuqi.

Neni 30  
**Përfundimi**

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi deri në përfundimin nga njëri Shtet Kontraktues. Secili Shtet Kontraktues mund të përfundojë Marrëveshjen duke dhënë njoftimin me shkrim të përfundimit, nëpërmjet kanaleve diplomatike, të paktën gjashtë muaj përpara përfundimit të çdo vitit kalendarik, që fillon pas mbarimit të një periudhe pesëvjeçare nga data e hyrjes në fuqi të saj. Në rast të tillë, Marrëveshja do të pushojë së pasuri efekt lidhur me të ardhurat e realizuara ose kapitalin e zotëruar me ose pas datës së parë të janarit të vitit kalendarik që ndjek vitin në të cilin është dhënë njoftimi i përfundimit.

Në praninë e duhur, nënshkruesit, të autorizuar në mënyrën e duhur, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Pekin më 13 shtator 2004, në dy kopje, në gjuhën shqipe, kineze dhe angleze, të gjitha janë autentikisht të njëjlojta. Në raste divergjencash midis teksteve, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

**LIGJ**  
**Nr. 9384, datë 4.5.2005**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KORPORATËS AMERIKANE “LOCKHEED MARTIN GLOBAL INC (LMGI)”, PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT TË INTEGRUAR TË VËZHGIMIT TË HAPËSIRËS DETARE”, NËN SHKRUAR NË TIRANË MË 15 MARS 2005**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

## Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Korporatës Amerikane “Lockheed Martin Global INC (LMGI)”, për ndërtimin e sistemit të integruar të vëzhgimit të hapësirës detare”, nënshkruar në Tiranë më 15 mars 2005.

## Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4590, datë 1.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**

### MARRËVESHJE

#### NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KORPORATËS AMERIKANE “LOCKHEED MARTIN GLOBAL INC (LMGI)” PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT TË INTEGRUAR TË VËZHGIMIT TË HAPËSIRËS DETARE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Korporata “Lockheed Martin (LMGI)”, me adresë: Lockheed Martin Global, INC, Bethesda, Maryland, USA,

*duke pasur parasysh* faktin që kjo korporatë është prezente në Republikën e Shqipërisë me ndërtimin e sistemit të modernizimit të kontrollit ajror dhe me qëllim realizimin e një sistemi të integruar të vëzhgimit të hapësirës detare,

biem dakord si më poshtë:

## Neni 1

### Përcaktime

“Palët”	- Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes, - Korporata Amerikane “Lockheed Martin Global INC (LMGI)”
“Sistem”	Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD).
“Hapësirë detare”	Është vija bregdetare në të cilën do të funksionojë sistemi i integruar i vëzhgimit detar. Në të përfshihen pjesë nga ujërat e brendshme detare, deti territorial, zona fqinjë (në vazhdim) zona ekonomike ekskluzive.
“Ndërtim i sistemit”	Nënkupton studimin, hartimin e projektit të fizibilitetit, furnizimin e pajisjeve të SIVHD, konfigurimin e sistemit, programimin, integrimin e elementeve ekzistuese të sistemit të ndërlidhjes dhe informacionit, trajnimin e personelit, mbështetjen me pjesë këmbimi dhe periudhën e garancisë. Elementet e sistemit të SIVHD do të konsistojnë në sistemin e ndërlidhjes dhe informacionit, sistemin e sensorëve të vëzhgimit të hapësirës detare, qendrat dhe elementet e përpunimit të informacionit, sistemin e identifikimit automatik të objektivave detare dhe programet kompjuterike të integrimin dhe shfaqjes së informacionit në monitorë etj., elemente të cilat do të përshkruhen në mënyrë të hollësishme në kontratë.

Neni 2  
**Qëllimi i Marrëveshjes**

Kjo Marrëveshje ka për qëllim përcaktimin e detyrimeve reciproke që palët marrin përsipër për zbatimin e projektit për sigurimin e një sistemi të integruar të vëzhgimit të hapësirës detare që realizon zbulimin, identifikimin dhe monitorimin e veprimtarisë së anijeve të tonazheve të ndryshme në hapësirën detare shqiptare dhe planizimin e operacioneve të kërkim-shpëtimit, duke përdorur teknologji bashkëkohore.

Neni 3  
**Bashkëpunimi**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Korporata Amerikane “Lockheed Martin Global INC (LMGI)” do të koordinojnë veprimtaritë për përmbushjen me sukses të kësaj marrëveshjeje. Palët do të negociojnë një kontratë të pranuar bashkërisht për ndërtimin e SIVHS në përputhje me rregullat e prokurimit të legjislacionit shqiptar. Detajet financiare, si çmimi dhe transferimi i pagesave, do të përcaktohen në kontratën e detajuar. Kontrata e detajuar do të parashikojë edhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Neni 4  
**Ndërtimi i sistemit**

Pas nënshkrimit të kontratës së detajuar, sistemi i integruar i vëzhgimit të hapësirës detare do të ndërtohet nga Korporata Amerikane “Lockheed Martin Global INC (LMGI)” dhe do të monitorohet nga Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë. Kontrata e detajuar ndërmjet palëve do të përfshijë elementet përbërëse të ndërtimit të sistemit.

Neni 5  
**Shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit**

Palët sigurojnë mbrojtjen e informacioneve të të dhënave që përfitohen nga bashkëpunimi në këtë projekt.

Neni 6  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga të dyja palët dhe ratifikimit nga Parlamenti Shqiptar.

Neni 7  
**Dispozita të fundit**

Kjo Marrëveshje do të pasohet me nënshkrimin e kontratës së detajuar midis palëve.

Kjo Marrëveshje mund të përfundohet nga secila palë në çdo kohë duke njoftuar me shkrim 60 ditë përpara, nëse palët nuk do të bien dakord për kushtet e kontratës së detajuar.

Marrëveshja do të nënshkruhet në dy kopje origjinale secila në gjuhën shqipe dhe angleze. Çdo negociatë ose dokument i lidhur me të, përfshirë edhe kontratën e detajuar, do të përkthehet në të dyja gjuhët. Varianti në gjuhën angleze i marrëveshjes dhe i dokumenteve do të ketë përparësi.

Ndrejje gabimi

Në Fletoren nr.30 të vitit 2005 në faqen nr.1142

Ishte: Pogradec 1 (një)

Bëhet: Pogradec 2 (dy)

**Fletorja Zyrtare gjendet:**

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:  
Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".  
Tel: 042 555 63; 267 468

**Për çdo lloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:**

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

**BOTIMET:**

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

**DOLI NGA SHTYPI:**

**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004**  
**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004**

Doli nga shtypi më 13.6.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2005

Çmimi: 150 lekë